



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



BULETINI

VËLLIMI 1
2009-2016

REPUBLIKA E KOSOVËS

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA
DHE PARASHTRESA

MAJ 2017

Botues: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Bordi redaktues: Rafet Haxhaj – anëtar i PZAP-it dhe kryesues i grupit punues për hartimin e Buletinit, Fejzullah Rexhepi – anëtarë i PZAP-it, Faton Ademi – anëtarë i PZAP-it, Adnan Konushevc – anëtarë i PZAP-it, Mulë Desku – Kryesues i Sekretariatit të PZAP-it, Florije Krasniqi – Zyrtare e Lartë Ligjore, Kudret Hasani – Zyrtarë i Lartë Ligjor, Valbona Millaku – Zyrtare e Lartë Ligjore, Vrion Krasniqi – Zyrtar i Teknologjisë Informative (TI), Fuad Jamini – Koordinator i Përkthimeve, Antigona Murati – Asistente Ekzekutive.

Kontribuuesit: Gyltene Sylejmani – Kryesuese e PZAP-it, Hasan Shala – anëtarë i PZAP-it, Ymer Hoxha – anëtarë i PZAP-it, Zyhdi Haziri – anëtarë i PZAP-it, Afijete Sada- Glllogjani – anëtare e PZAP-it, Nenad Llazić – anëtarë i PZAP-it dhe Nazmije Ibrahim – Ish Kryesuese e PZAP-it.

© Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Të drejtat e autorit: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përgjashtim i përgjegjësisë: Sipas nenit 118.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, vendimet e PZAP-it publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e PZAP-it. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e PZAP-it. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të publikuara nga PZAP-i, mbizotëron versioni origjinal i vendimit i arkivuar në arkivin e PZAP-it dhe i cili është i publikuar në web faqen zyrtare të PZAP-it. Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të PZAP-it.

Parathënie



Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që në cilësinë e kryesueses së PZAP-it të shkruaj këtë parathënie për buletinin e – I – rë me vendime të PZAP-it për zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunave si dhe për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës nga viti 2009–2016. Buletini i këtillë do të jetë pikë referimi për ata që punojnë dhe që merren me proceset zgjedhore në Kosovë. Me rastin e përgatitjes së këtij Buletini jemi

përkushtuar të tregojmë disa rezultatet kryesore të punës së PZAP-it për periudhën e theksuar më lartë.

Ky edicion i parë i Buletinit përmban një numër të rasteve më të veçuara dhe më të rëndësishme të vendimeve për të gjitha fazat e procesit zgjedhore dhe pas zgjedhor përfshirë rastet e vendimeve që kanë të bëjnë me ankesat e subjekteve politike të parashtruara lidhur me:

Fillimin e fushatës para fillimit zyrtar të Fushatës Zgjedhore, Fillimin zyrtar të Fushatës Zgjedhore, Thyerjen e Heshtjes Zgjedhore, Ditën e Zgjedhjeve, Administrimin e Rezultateve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe Mos deklarimin e Raporti Financiar.

PZAP-i ka nxjerre vendime të rëndësishme për të gjitha fazat e procesit zgjedhor të zgjedhjeve të organizuara në Kosovë nga viti 2009 – 2016, por ndër vendimet me të rëndësishme të PZAP-it janë ato me të cilat ka anuluar rezultatet votimit në disa Qendra të Votimit në Zgjedhjet Komunale të Vitit 2009 dhe në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2010 dhe ka urdhëruar Komisionin Qendror për përsëritjen e votimit në ato Qendra të votimit.

Vlen të theksohet e të përsëritet se sa është e rëndësishme që parashtruesit e ardhshëm të ankesave dhe apeleve të synojnë dorëzimin e ankesave dhe apeleve në PZAP duke përdorur këtë buletin, të konsultoj me vëmendje vendimet e PZAP-it në rastet e ngjashme dhe të marrin parasysh nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi në dritën e rasteve të ngjashme. Duhet kuptuar qartë që parimisht e drejta e ankesës nuk mund të mohohet asnjë parashtruesi, por do të ishte e dobishme që ata paraprakisht të njoftoheshin me buletinin e PZAP-it dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e ankesave të tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të PZAP-it është t'i tregohet opinionit të gjerë të anëtarët e PZAP-it i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për të gjithë stafin e PZAP-it, me punën dhe me përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi i këtij edicioni të para të buletinimit me vendime të PZAP-it. Gjithashtu falënderojmë Fondacionin Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore për mbështetjen teknike të botimit të këtij Buletini.

Gyltene Sylejmani
Kryesuese e PZAP-it

Përmbajtja

2009

VENDIMI Anr. 227/2009, Anulim i Zgjedhjeve	8
VENDIMI Anr.508/2009, Rivotimi	14

2010

VENDIMI Anr.579/2010, Mbajtja dhe ekspozimi i armës në QV nga personi i pautorizuar	20
---	----

2012

VENDIMI Anr. 56/2012, Vendorsja e posterave në objekte publike gjatë fushatës zgjedhore	24
VENDIMI Anr.95/2012, Mospërfshirja në Listën e Votuesve	29

2013

VENDIMI Anr. 26/2013, Refuzim i aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve	33
VENDIMI Anr. 74/2013, Mosregjistrimi i Iniciativës Politike në regjistrin e partive politike në ZRPPC	35
VENDIMI Anr.109/2013, Tërheqjen nga lista si Kandidatë për Anëtare të Kuvendit të Komunës	38
VENDIMI Anr.500/2013, Fotografim i fletëvotimit gjatë votimit dhe parregullsi të ndryshme	40
VENDIMI Anr.537/2013, Përleshje fizike	47
VENDIMI Anr.594/2013, Thyerja e heshtjes zgjedhore-Postimi i një statusi dhe publikimi i një fotografie në rrjetin social Facebook	50
VENDIMI Anr.716/2013, Shpallja e rezultateve preliminare	53
VENDIMI Anr.931/2013, Anulim dhe Rivotim	55

2014

VENDIMI Anr.27/2014, Mosdeklarim i Raportit Financiar	62
VENDIMI Anr.75/2014, Ndikim tek votuesit përmes shpërblimit për të votuar subjektin politik	65
VENDIMI Anr.79/2014, Ndalim i publikimit të posterave promovues B2	68
VENDIMI Anr.185/2014, Shfrytëzimi i shërbyesve publik për zhvillimin e fushatës zgjedhore	71
VENDIMI Anr.188/2014, Rishikimi i vendimit të PZAP-it	74
VENDIMI Anr.190/2014, Vendorsja e njoftimeve në vende të palejuara për mbajtjen e tubimit përmbyllës të fushatës	76
VENDIMI Anr.236/2014, thyerja e heshtjes zgjedhore-shpërndarja e SMS	90
VENDIMI Anr.259/2014, Blerja e votave gjatë ditës së zgjedhjeve	93
VENDIMI Anr.266/2014, Mospërputhja e rezultateve në mes të nënshkrimeve në librin e votuesve	96
VENDIMI Anr.281/2014, Manipulim me formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK)	99

VENDIMI Anr.392/2014, Parregullsi në rezultatin përfundimtar të publikuara-bartja e votave të kandidati tjetër	102
VENDIMI Anr.393/2014, Kundër rezultatit preliminar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)	105
VENDIMI Anr.409/2014, Rezultati përfundimtar i publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)	108
VENDIMI Anr.436/2014, Kundër rezultatit përfundimtar të publikuar	111

2016

VENDIMI Anr.93/2016, Anulimi i vendimit të KQZ-së	116
VENDIMI Anr.100/2016, Vendosja e posterit në shtyllë publike	121
VENDIMI Anr.110/2016, Asistim për të votuar	125
VENDIMI Anr.112/2016, Thyerja e heshtjes zgjedhore-Postimi i një statusi dhe publikimi i një fotografie në rrjetin social FCB	128
VENDIMI Anr.124/2016, Vendosja e posterit në afërsi të Qendrave të Votimit	130



BULETINI

2017



2009

VENDIMI Anr. 227/2009,

Anulim i Zgjedhjeve

Pas ditës së zgjedhjeve më 15 Nëntor 2009, KZAP ka pranuar një numër të madh ankesash lidhur me mashtrimet gjatë zgjedhjeve, parregullsitë dhe gabime gjatë votimit dhe numërimit në disa QV dhe VV si në: Gjakovë, Shtërpçë, Shtime dhe Lipjan.

Gjatë rinumërimit të fletëvotimeve nga ana e QNR-së për këto QV dhe VV është vërtetuar se parregullsitë që ishin të shumta dhe se rezultatet tejet të shtrembëruara, kështu që KZAP-i vendosi që të udhëzoj KQZ-në që ti shpallë të pavlefshme të gjitha fletëvotimet dhe të anuloi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në QV dhe VV komunave të cekura më lartë.

A nr. 227 / 2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, në seancën e mbajtur më 24.11.2009, mori;

VENDIM

Lidhur me çështjen e disa ankesave të parashtruara në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në lidhje me pohimet për mashtrime gjatë zgjedhjeve dhe për parregullsi dhe gabime serioze gjatë votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotimeve të ndryshme.

KZAP-ja e urdhëron KQZ-në që të anulohë rezultatet e zgjedhjeve në këto Vendvotime (VV):

VV.0219C/01R;	VV.0219C/02R;	VV.0219C/03R;	VV.0219C/04D
VV.0213C/01R;	VV.0213C/02R;	VV.0213C/03R;	VV.1304E/01R;
VV.1304E/02R;	VV.1304E/03R;	VV.0203X/01R;	VV.2305/03D;
VV.2209E/01R;	VV.2209E/02D;	VV.3032A/02R;	

FAKTET

Pas ditës së zgjedhjeve më 15 Nëntor 2009, KZAP ka pranuar një numër të madh ankesash lidhur me mashtrimet gjatë zgjedhjeve dhe parregullsi dhe gabime gjatë votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotimeve të ndryshme.

KZAP-i ka pranuar raporte lidhur me rezultatet e rinumërimit përfshirë edhe dëshmitë e dokumentuara në të gjitha rastet.

Në pesëmbëdhjetë (15) vendvotime rezultatet e numërimit kanë ofruar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073), Neni 117.4 parasheh si vijon:

117.4 KZAP-i mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin.

KZAP nuk mendon që urdhri për rinumërim në të gjitha rastet sipas nenit 117.4 të LZP-së, ofron mjete efikase lidhur me shkeljen e ligjit për zgjedhjet. Në disa raste ishte e mundur të bëhet korrigjimi i parregullsive duke i rinumëruar fletëvotimet në Qendrën e Numërimit dhe te Rezultateve (QNR). Megjithatë, në pjesën tjetër korrigjimi i tillë ishte i pamundur për shkak të shkallës së madhe të parregullsive. KZAP-i ka pritur që kjo mund të ndodhë dhe prandaj e ka rezervuar të drejtën për të urdhëruar mjete të mëtejshme juridike me vendimin për urdhërimin e rinumërimit, si vijon¹:

KZAP ka vërejtur se mund të kërkohet përgatitje plotësuese për të vërë rinumërimin në këto raste për të siguruar përgatitje efikase ndaj shkeljeve të cilat janë bërë. Prandaj, KZAP gëzon të drejte të urdhëroj mjetet të tjera lidhur me këtë ankesë.

Bazuar në Nenin 120.1 (Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve) të LZP, në rast se KZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet:

b) ... për të anuluar rezultatet në një vendvotim apo të udhëzoj KQZ-në të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër votimi.

Duke u bazuar në rezultatet e rinumërimit KZAP-i ka përcaktuar që në 15 vendvotime nuk është e mundur që vetëm me anë të rinumërimit të ofrohet korrigjim efikas, ose rinumërimi ka privuar dhe theksuar edhe më parregullsitë serioze dhe mashtrimin zgjedhor të shkaktuar me qëllim. Në këtë kontekst nënkuptohet vetvetiu që nuk është gjithmonë e mundur të dallohen votat legjitime

¹Shih, për shembull, KZAP A 86,90/2009; A 87,92/2009; A 96/2009; A 98/2009; A 114/2009; A 142/2009; A 144/2009.

nga ato mashtruese.

Përveç kësaj, kjo nuk do t'i kontribuonte korigjimit të duhur të rezultateve po të shpallëshin të pavlefshme fletëvotimet të cilat është e qartë që janë ndryshuar gjatë procesit të numërimit, sepse kjo do ta dëmton subjektin politik të zgjedhur nga votuesit.

Për sa i përket mjetit të ndreqjes së gabimeve, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i sipërpërmendur, parasheh vetëm përsëritjen e votimit në Qendrat e caktuara të votimit. Mirëpo ky mjet nuk është as i përshtatshëm e as i arsyeshëm. Nuk duhet injoruar fakti se për shkak të rëndësisë fundamentale të zgjedhjeve demokratike të Kosovës, çfarëdo vendimi për përsëritjen e votimit duhet të marrë parasysh kontekstin e gjerë social dhe politik në Kosovë. Duke pasur parasysh këtë kontekst të caktuar, dëmi i shkaktuar nga përsëritja e votimit do të mund ta tejkalonte tej mase përfitimin që do të arrihej me anë të kësaj mase.

Përsëritja e votimit, qoftë edhe vetëm në një numër të vogël të Vendvotimeve, do të dërgonte drejt vonesave të konsiderueshme në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve në mbarë Kosovës. Kjo do të shkaktonte pasiguri të madhe e cila në gjendjen aktuale politike do të ishte e dëmshme për interesin e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, përsëritja e votimit nuk do të kontribuonte në arritjen e rezultateve më të sakta. Votuesit të cilët do të ftoheshin për të votuar do ta dinin rezultatin e votimit fillestar në komunën e tyre dhe në të gjitha komunat tjera. Kjo, në mënyrë të qartë, do të ndikonte në veprimet e tyre. Për më shumë, nuk mund të injorohet fakti se përsëritja e votimit do të bëhej në kushte të ngjashme me ato të votimit fillestar, duke hapur mundësinë që të manifestohen të njëjtat probleme përsëri.

Duke i pasur parasysh këto arsye, si dhe faktin se parregullsitë dhe mashtrimet zgjedhore janë vërtetuar si të bazuara në jo më shumë se 15 prej 2, 256 Vendvotime, do të ishte e tepërt dhe e paarsyeshme të urdhëroj përsëritjen e votimit në Qendrat përkatëse të votimit. Në anën tjetër, këto parregullsi dhe shkelje të ligjit kërkojnë një reagim të fuqishëm. Veçanërisht mashtrimet zgjedhore të caktuara, që janë kryer nga anëtarët ose së paku në bashkëpunim me anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve, nuk duhet toleruar. Prandaj, KZAP-ja duhet të shqyrtoj nëse ekziston ndonjë mjet juridik i cili ka ndikim më pak të dëmshëm në procesin zgjedhor, ndërsa në të njëjtën kohë t'i adresojë qartazi dhe t'i dënojë shkeljet skandaloze të ligjit. Gjatë shqyrtimit të opsioneve për këtë zgjidhje, menjëherë bëhet e qartë se çfarëdo mjeti juridik i ka edhe disfavoret e veta. Nuk është e mundur që të kthehet koha mbrapsht dhe të ndreqen shkeljet sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Prandaj, KZAP duhet të zgjedh mjetin juridik

me ndikimin më të vogël në të drejtat e votuesve.

KZAP-ja është e mendimit se ky mjet i vetëm juridik do të ishte udhëzim i KQZ-së që t'i shpallë të pavlefshme të gjitha fletëvotimet dhe t'i anulojë rezultatet në Vendvotimet në fjalë. Kësisoj, ndikimet negative të mësipërme në procesin zgjedhor do të mund të shmangeshin dhe në të njëjtën kohë rezultatet do të korrigjoheshin. Kompetencat e KZAP-it për të udhëzuar KQZ-në për t'i shpallur fletëvotimet të pavlefshme rezultojnë nga autoriteti bazuar në LZP-në, Neni 120.1, për ta udhëzuar KQZ-në që të urdhëroj përsëritjen e votimit.

Përveç kësaj, KZAP-i konsideron se duke udhëzuar shpalljen e pavlefshme të të gjitha votave në këto Vendvotime, vullneti i përgjithshëm i votuesve në secilën Komunë do të shprehej më mirë, sepse rezultatet përfundimtare nuk do të përfshinin një numër të madh të votave të shtrembëruara ose të manipuluar të hedhura në këto vendvotime.

KZAP thekson se në rastet për të cilat Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) nuk ka paraqitur raportet complete lidhur me rinumërimin, rezultatet duhet të shpallen të pavlefshme gjithashtu, sepse pohimet e Ankesave të cilat kanë qenë baza e urdhërimit të rinumërimit, janë shumë serioze dhe nuk janë eliminuar me anë të barazimit gjatë rinumërimit. Po ashtu, KZAP-i i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e dokumentuara të siguruar nga QNR. Vlerësimi i këtyre provave është marrë parasysh gjithashtu.

Bazuar në ligjin e sipërpërmendur, KZAP-i e udhëzon KQZ-në që t'i anulojë rezultatet në vendvotimet e mëposhtme për shkak të arsyeve individuale të përcaktuara në lidhje me secilin e Vendvotim.

Fjala është për Vendvotimet e mëposhtme:

Qendra e Votimit 0219C – Gjakovë – Novosellë

(është urdhëruar rinumërimi bazuar në vendimin e KZAP-it A 86.90/2009)

VV. 0219C/01R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

VV. 0219C/02R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

VV. 0219C/03R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

VV. 0219C/04D Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

Qendra e Votimit 0213C – Gjakovë – Demjan

(është urdhëruar rinumërimi bazuar në vendimin e KZAP-it A 87,92/2009)

VV. 0213C/01R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

VV. 0213C/02R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

VV.0213C/03R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

Qendra e Votimit 0203X – Gjakovë – Bajram Curr

(është urdhëruar rinumërimi bazuar në vendimin e KZAP-it A 114/2009)

VV. 0203X/01R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar.

Qendra e Votimit 2305 – Shtërpce – Firajë

(është urdhëruar rinumërimi bazuar në vendimin e KZAP-it A 144/2009)

VV. 2305/03D; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar. Përveç kësaj, ka pasur devijime të papranueshme në numrin e fletëvotimeve të pranuar dhe numrin e votave totale të pranuar, sic dëshmohet në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve

Qendra e Votimit 2209E – Shtime – Pjetërshticë

(është urdhëruar rinumërimi bazuar në vendimin e KZAP-it A 142/2009)

VV. 2209E/03D; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar. Përveç kësaj, ka pasur devijime të papranueshme në numrin e fletëvotimeve të pranuar dhe numrin e votave totale të pranuar, sic dëshmohet në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve.

Qendra e Votimit 1304E – Lipjan – Shalë

(është urdhëruar rinumërimi bazuar në vendimin e KZAP-it A 98/2009)

VV. 1304E/01R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar. Përveç kësaj, ka pasur devijime të papranueshme në numrin e fletëvotimeve të pranuar dhe numrin e votave totale të pranuar, sic dëshmohet në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve.

VV. 1304E/02R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar. Përveç kësaj, ka pasur devijime të papranueshme në numrin e fletëvotimeve të pranuar dhe numrin e votave totale të pranuar, siç dëshmohet në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve.

VV. 1304E/03R; Një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve është falsifikuar. Përveç kësaj, ka pasur devijime të papranueshme në numrin e fletëvotimeve të pranuar dhe numrin e votave totale të pranuar, siç dëshmohet në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve.

KZAP-i rekomandon fuqishëm KQZ-në që në raundin e dytë (balotazh) të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave të ndërroj Këshillat e vendvotimeve në këto vendvotime.

Meqenëse numri i vendvotimeve në të cilat kanë ndodhur parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim elektoral paraqet vetëm një numër të vogël të numrit të përgjithshëm të vendvotimeve në Republikën e Kosovës, KZAP-i konsideron se këto parregullsi nuk kanë ndikuar në vlefshmërinë e rezultateve të zgjedhjeve.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 227 / 2009 më datën 24.11.2009.

Kryesuesi i Panelit / **Osman Tmava**

VENDIMI Anr.508/2009,

Rivotimi

Anr.508/2009– Është një vendim i marr nga KZAP-i në lidhje me pohimet për mashtrime gjatë zgjedhjeve dhe për parregullsi dhe gabime serioze gjatë votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe në vendvotime.

Në këtë vendim janë përfshirë një grup i madh i ankesave nga subjekte të ndryshme politike të cilat pretendimet e tyre ankimore i kanë paraqitur për Komunën e Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit.

Pas gjetjeve të lëshimeve dhe parregullsive të shumta, në këto VV dhe QV rezultoi përsëritja e votimit në këto komuna si: Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit.

A nr. 508/ 2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Ymer Hoxha, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, në seancën e mbajtur më 19.12.2009, mori;

VENDIM

I. Pranohen të bazuara ankesat: A nr. 401; 402; 413; 414; 418; 421; 422; 423; 424; 425; 426; 427; 428; 429; 430; 431; 438; 440; 441; 442; 447; 448; 452; 453; 454; 455; 456; 457; 458; 459; 460; 482; 483; 484; 485; 488; 489; 497; 498; 499; 500; 501; 506.

II. Udhëzohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të urdhëroj përsëritjen e votimit në Komunën e Prizrenit, Komunën e Gjilanit dhe Komunën e Lipjanit.

FAKTET

Pas ditës së zgjedhjeve për Kryetar të Komunave më 13 Nëntor 2009 për Raundin e II-të, KZAP ka pranuar një numër të madh ankesash lidhur me mashtrimet gjatë zgjedhjeve, parregullsi dhe gabime gjatë votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotimeve të ndryshme.

Në Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 6.3 (Vendimet për ankesat) parasheh si vijon:

“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryetari i Komisionit mund të vendos të bëjë konsolidimin e ankesave që ngërthejnë në vete çështje të ngjashme, dhe Komisioni i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”.

Prandaj, KZAP do të adresoj të gjitha ankesat nga Komuna e Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit në këtë vendim.

Po ashtu, KZAP-i ka pranuar një vendim nga KQZ më datë 16.12.2009 për anulim të rezultateve të Raundit të II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave në disa vendvotimeve në lidhje me parregullsitë dhe mospërputhjet në mes të numrit të përgjithshëm të Fletëvotimeve të hedhura dhe Regjistrit të Votuesve në një Vendvotim, mbi nivelin e tolerancës së paraparë me vendim të KQZ-së, fletëvotimeve me kusht të paidentifikuara, FLV-ve të VNV-ve pa zarfa të sigurisë si dhe nënshkrime të dyfishta, në Komunën e Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit.

Prizren:

Për komunën e Prizrenit, KZAP ka pranuar ankesa në lidhje me parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, për 31 nga 60 qendra të votimit.

KZAP ka pranuar ankesa valide nga këto qendra votimi të specifikuar më poshtë:

QV: 2001A; 2002A; 2005X; 2009A; 2013A; 2014A; 2015A; 2016A; 2019A; 2021A; 2023A; 2024A; 2025A; 2026A 2027A; 2033A; 2034A; 2035A; 2036A; 2037A; 2038A; 2040A; 2041A; 2042A; 2051A; 2054A; 2059A; 2065A; 2069A; 2067A; 2068A.

Gjatë hetimeve të tij në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KZAP ka zbuluar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, në shumicën e këtyre ankesave.

Gjilan:

Për komunën e Gjilanit, KZAP ka pranuar ankesa në lidhje me parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, për 21 nga 31 qendra të votimit.

QV: 0401D; 0401X; 0402D; 0402X; 0404D; 0405D; 0406D; 0407D; 0408D; 0409D; 0410D; 04015D; 0421D; 0422D; 0428D; 0429D; 0437D; 0439D; 0440D; 0441D.

Gjatë hetimeve të tij në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KZAP ka zbuluar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, në shumicën e këtyre ankesave.

Lipjan:

Për komunën e Lipjanit, KZAP ka pranuar ankesa në lidhje me parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, për 14 nga 26 qendra të votimit.

QV: 1303E; 1304E; 1305E; 1306E; 1307E; 1308E; 1322E; 1323E; 1325A; 1326E; 1327E; 1328E; 1329E; 1330E.

Gjatë hetimeve të tij në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KZAP ka zbuluar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, në shumicën e këtyre ankesave.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073), Neni 120.1, pika b) **Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve** parasheh si vijon:

b) Para certifikimit të rezultateve zgjedhore, dhe në rrethana të jashtëzakonshme është në zgjedhjen e vetë KZAP-it, për të anuluar rezultatet në një vendvotim apo të udhëzoj KQZ-në të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër votimi.

Po ashtu, Neni 106.2 (**Rezultatet Zgjedhore**), parasheh si vijon:

106.2 Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë.

Siç përcaktohet me lartë, LZP i ka mundësuar KZAP-it dy mjete juridike, kur shkelja serioze ka ndodhur dhe që rrezikon të minoj integritetin e zgjedhjeve. Asnjë mjet juridik nuk është ideal dhe secili mban reperkusionet e veta. Por i tillë është problemi me mashtrimet zgjedhore prandaj nuk është e mundur që të kthehet koha mbrapa dhe të ndreqen shkeljet sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Bazuar në rezultatet e hetimeve tona, KZAP ka përcaktuar se ka pasur mashtrime dhe vjedhje të mëdha të votave në këto tri komuna, prandaj udhëzimi i KQZ-së për të anuluar rezultatet të caktuara në disa vendvotime, do të ishte i pamjaftueshëm

për të përmirësuar këto parregullsi dhe shkelje të ligjit.

KZAP konsideron se anulimi i rezultateve në një numër të konsideruar të vendvotimeve, do të ishte përgjigje jo adekuate për këto parregullsi dhe vjedhje masive. Së pari, anulimi i mbi 50% të vendvotimeve nuk do të shprehte plotësisht vullnetin e qytetarëve të këtyre komunave, sepse votat të mbetura nga këto vendvotime do të ishin në numër të vogël dhe si pasojë do të dëmtonte vullnetin e zgjedhësve të këtyre komunave dhe do të dëmtonte legjitimitetin e të zgjedhurve.

Së dyti, edhe nëse KZAP do të anulonte vendvotimet më problematike, për shkak të ngushtësisë së ndryshimit të rezultateve pre-eliminare, çdo anulim i tillë potencialisht do të bënte njërin kandidatë fitues. Jo vetëm që KZAP nuk do të konsideronte këtë zgjedhje të mirë, gjë që do të bënte një kandidat fitues por po ashtu duke konsideruar që janë një numër i konsideruar i mashtrimeve dhe parregullsive nga dy kampet e kandidatëve për kryetarë, pashmangshmërisht KZAP e vlerëson të gabueshme të shpërblej një subjekt politik me duar të papastërta. Duke ju referuar maksimës latine:

“Nemo ex dolo suo proprio relevetur aut auxillium capiat”. Le të mos fitoj askush dobi nga mashtrimet e tij.

Në këtë mënyrë, i vetmi mjet juridik që do të reflektuar në vullnetin e qytetarëve të këtyre komunave, do të ishte që të udhëzoj KQZ-në që të urdhëroj përsëritjen e votimit në këto tri komuna, si mjet i vetëm juridik i duhur në këto rrethana.

KZAP e kupton që edhe në vetëm disa komuna, përsëritja e votimit do të qonte drejt vonesave të konsiderueshme në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve në këto vende. Megjithatë, e drejta për të votuar dhe për të zgjedhur është ngushtë e lidhur me themelet e demokracisë, dhe si e tillë, mbrojtja e votës së lirë të sovranit mbi të gjitha është detyrim madhor dhe kusht për të reflektuar drejtë në vullnetin e çdo qytetari në Republikën e Kosovës.

KZAP nuk mendon që udhëzimi për rinumërim në këtë rast, ofron mjete efikase lidhur me shkeljen e ligjit për zgjedhjet. Andaj, KZAP rezervon të drejten që të urdhëroj mjete të mëtejshme juridike lidhur me këto ankesa.

Për më tepër, KZAP-i rekomandon fuqishëm KQZ-në për qëllim të mbarëvajtjes së procesit të votimit, që gjatë ditës zgjedhjeve, të ndërmarrë masa në këto tri komuna:

- Të bëhet ndërrimi i komisionarëve të Qendrave të Votimit;
- Të shtohet prezenca e Policisë së Kosovës në të gjitha Qendrat e Votimit dhe;
- KQZ të shtoj mbikëqyrjen gjatë procesit të votimit.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 508 /2009 më datën 19. 12.2009

Kryesuesi i Panelit / **Osman Tmava**

2010

VENDIMI Anr.579/2010,

Mbajtja dhe ekspozimi i armës në QV nga personi i pautorizuar

Parashtruesi i ankesës N.N, ka pretenduar se në QV Nr. 2006/a, gjatë ditës së votimit, koordinatori i vëzhguesve të subjektit politik (X.X) ka mbajtur armën e tij.

Më këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se kjo përbën shkelje të nenit 33 pika c) të LPZ-së, prandaj PZAP-i për këtë çështje ka vendosur konform dispozitave ligjor te nenit 120 paragrafi 1 pika c) lidhur me nenin 120 par. 3 pika d) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

A nr. 579/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përberë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e N.N, paraqitur kundër I.B koordinatori i vëzhguesve të subjektit politik X.X në QV 2006/a në Tusus të Prizrenit, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e **N.N**

- I.** Subjektit politik **X.X**, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e Republikës së Kosovës.
- II.** **I.B** i lindur me 19.11.1972 me nr. identifikimi, në cilësinë e koordinatorit të vëzhguesve të subjektit politik X.X në vendvotimin 2006/a në lagjen Tusus të Prizrenit, i ndalohet për 4 (katër) vite, të marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së si kandidat dhe 6 (gjashtë) vite, si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor te mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, duke filluar nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga N.N, në të cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në QV Nr. 2006/a në lagjen Tusus të Prizrenit, koordinatori i vëzhguesve të subjektit politik X.X, ka mbajtur armën e tij të tipit "TT" kalibri 8.9 mm, prej hapjes së vendvotimit e deri kur është arrestuar nga njësitet e policisë dhe është dërguar në stacionin e policisë, ku me atë rast i është konfiskuar arma, mirëpo i njëjti me urdhër të prokurorit është liruar. Sipas parashtruesit te ankesës kjo përbën shkelje te nenit 33 pika c) te LPZ-se".

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numrat kontaktues të personave (P.K) (Q.H), (H.B) dhe (S.H) në cilësinë e dëshmitarëve.

Në raportin e policisë dt. 12.12.2010 me Nr. reference 2010-GA-3726, të lëshuar nga rreshteri policor A.M, ku njofton se: Me datën 12.12.2010 rreth orës 15:45 është marr informacioni se në vendvotimin në shkollën fillore "Fadil Hisari" *kordinator i PBD-së* është i armatosur. NJSO ka dal në vendin e ngjarjes dhe ka kontaktuar me të dyshuarin I.B, i lindur me 19.11.1972 në fshatin Lez dhe me banim në Prizren, rruga Zahir Pajaziti ku ka pranuar se posedon një armë M57 prodhim Jugosllav të kalibrit 7.62 për të cilën nuk posedon leje dhe 9 fishekë të të njëjtit kalibër. Arma është konfiskuar dhe me zinxhirin ruajtës është dërguar në Forensikë. Në konsultim me prokurorin e Qarkut rasti shkon në procedurë të rregulltë.

Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi

Neni 34.2 parasheh si vijon:

Asnjë subjekt politik ose kandidatet nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor.

Neni 8 paragrafi 1 i Rregullës Zgjedhore nr. 11/2009, parasheh;

Shkelja e njërit nga këto nene të kodit të Sjelljes, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

120.1 c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Neni 120 paragrafi 3 pika (d) i LZP-së, parasheh se:

120.3 d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite.

Duke vendosur për gjobën PZAP ka marrë si rrethanë rënduese se shkelja ka të bëjë me veprimet e ndaluara dhe thyerjen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. PZAP sa i përket ndalimit për pjesëmarrje si koordinator i vëzhguesve siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë se shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e votimit. Prandaj nga arsyet e lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 579/2010 më datën **16.12.2010**

Kryesuesi i Panelit / **Nehat Idrizi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

2012

VENDIMI Anr. 56/2012,

Vendosja e posterave në objekte publike gjatë fushatës zgjedhore

Parashtruesit e ankesave nga subjektet politike N.N. dhe X.X. kanë pretenduar se subjekti politik Y.Y. ka vendosur postera me përmbajtje garuese në objektin komunal, gjatë fushatës zgjedhore.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesit e ankesave se subjekti politik Y.Y. ka bërë shkeljen e legjislacionit të nenit 33 pika b) dhe nenin 120 paragrafi 1 pika c) i LZP-së si dhe nenin 3 paragrafi 1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009.

PZAP, pas shqyrtimit të lëndës vendosi të miratojë si të bazuar ankesën Anr.56 dhe Anr.61/2012, për vendosjen e posterave në objektin Komunal në Ferizaj, ndërsa refuzon ankesën Anr.56/2012, sa i përket pretendimeve ankimore për vendosjen e posterit në objektin e hekurudhave në Ferizaj.

A.nr. 56/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe, Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik N.N. dega në Ferizaj dhe X.X. dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Y.Y. dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHEN si të bazuara ankesat Anr. 56/2012 datë 24.04.2012, e subjektit politik N.N. dega në Ferizaj dhe Anr. 61/2012 datë 25.04.2012, e X.X. dega në Ferizaj, lidhur me vendosjen e posterave në objektin Komunal në Ferizaj nga ana e subjektit politik Y.Y. dhe për këtë subjektit politik Y.Y. dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1500 (njëmijepesëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr. 56/2012 datë 24.04.2012, e subjektit politik N.N. dega në Ferizaj Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me vendosjen e posterit nga ana e subjektit politik Y.Y. në objektin e hekurudhave në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP, me datën 24.04.2012, ka pranuar një ankesë A nr. 56/2012 nga subjekti politik N.N. dega në Ferizaj me të cilin pretendon se subjekti politik Y.Y. dega Ferizaj, me datën 23.04.2012, ka shfrytëzuar objektet dhe hapësirat publike komunale duke i vendosur posterat e kandidatit të saj për kryetar komune në Ferizaj, ku me ç'rast ka shkelur Rregullën Zgjedhore 13/2009.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa foto si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 25.04.2012, më Anr. 61/2012 nga X.X. në të cilën pretendohet se me datën 24.04.2012 në ora 21:30 në objektin e komunës së Ferizajt, gjatë fushatës zgjedhore nga anëtarët e subjektit politik Y.Y. janë vendosur posterat e kandidatit të subjektit politik Y.Y. për kryetar të komunës së Ferizajt N.F.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelja e nenit 33 pika a e LZP-së dhe Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik Y.Y. më datë 24.04.2012, për ankesën Anr.56/2012, që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e subjektit politik N.N. dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.04.2012, në ora 12:00.

PZAP-i, me datën 25.04.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Y.Y. lidhur me ankesën Anr.56/2012, e paraqitur nga subjekti politik N.N. në të cilën theksohet se parashtruesi i ankesës gjegjësisht subjekti politik N.N. nuk ka ofruar fakte nëse ato hapësira në të vërtetë janë objekte publike apo jo si dhe nuk vërehet asnjë tabelë njoftuese nëse objektet në fjalë janë ato për të cilat pretendohen pala ankuese, më tutje në përgjigje të ankesës theksohet se materiali zgjedhor është vendosur enkas për fotografim dhe janë larguar materialet tjera që kanë qenë të vendosura aty.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik Y.Y., më datë 26.04.2012, për ankesën Anr.61/2012, që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e X.X. dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 27.04.2012, në ora 12:00.

PZAP-i, me datën 27.04.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Y.Y. lidhur me ankesën Anr.61/2012, e paraqitur nga X.X. në të cilën potencohet se shtabi zgjedhor i Y.Y. nuk ka bërë vendosjen e materialit në fjalë në mënyrë të organizuar dhe nuk merr përgjegjësinë e vendosjes së materialit në fjalë, pasi që materiali zgjedhor i kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt N.F. nga radhët e subjektit politik Y.Y. janë publike dhe si të tilla mund të posedohen nga secili qytetar dhe për këtë arsye shtabi zgjedhor e ka të pamundur të kontrolloj qarkullimin dhe vendosjen e tyre.

Meqenëse kemi të bëjmë me dy raste të njëjta edhe pse ankesat janë të parashtruara në PZAP nga subjektet e ndryshme politike, PZAP-i duke i bazuar në nenin 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të tij vendosi t'i bashkoi këto dy ankesa si në vijim:

6.3 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim- marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë.

Nga procesverbali i datës 27.04.2012, i përpiluar pas verifikimit dhe hetimit të pretendimeve ankimore, i bërë në vendin e ngjarjes nga PZAP-i, lidhur me pretendimet e ankimore të bëra me ankesën Anr.56 dhe Anr.61/2012, sa i përket vendosjes së posterave në objektin komunal të Ferizajt po ashtu nga video incizimi i bërë në vendin e shkeljes së supozuar rezulton se posterat e subjektit politik Y.Y. kanë qenë të vendosura në objektin komunal të Ferizajt. Gjatë hetimeve PZAP-i ka vërejtur dhe konstatuar se subjekti politik Y.Y. ka bërë përpjekje serioze për evitimin e shkeljes së supozuar brenda një periudhe të shkurtër kohore i kanë larguar posterat nga objekti komunal.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me ankesën Anr. 56/2012, që ka të bëjë me vendosjen e posterave në objektin e hekurudhave, nga hetimi i zhvilluar dhe nga fotografit e bëra nga ana e PZAP-it, më datë 27.04.2012, nuk ka qenë e mundur të identifikohet se në objektin e hekurudhave kanë qenë të vendosura posterat e subjektit politik Y.Y. siç pretendohet në ankesën Anr.56/2012.

Veprimet e Ndalura të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i, përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit politik për ndonjë shkelje, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga fotografia e dorëzuara si provë dhe nga procesverbali i përpiluar dhe video incizimi i zhvilluar në vendin e ngjarjes nga PZAP-i me datë 27.04.2012, e që gjenden në shkresat e lëndës shihet se posterat e kandidatit për kryetarë të komunës së Ferizajt, N.F. nga radhët e subjektit politik Y.Y. kanë qenë të vendosura

në objektin komunal të Ferizajt siç ishte pretenduar në ankesat Anr.56 dhe Anr.61/2012, veprim të cilin PZAP-i e konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën, mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. PZAP-i, mori si rrethanë lehtësuese përpjekjet serioze që i kishte bërë subjekti politik Y.Y. për evitimin e shkeljeve të supozuar ngase i ka larguar posterat nga objekti komunal brenda një periudhe të shkurtër kohore, mirëpo nga mbetja e disa pjesëve të vogla të posterave të vendosura në murin e objektit komunal, është vërejtur se posterat ishin të subjektit politik Y.Y. ndërsa si rrethana rënduese PZAP-i gjeti se subjekti politik Y.Y. ka bërë shkelje të *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjatë. Nga të gjitha arsyet e sipërshënuara dhe më qëllim të evitimit të shkeljeve të pretenduara në ankesë e në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 56/2012 më datën **28.04.2012**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjopa e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.95/2012, Mospërfshirja në Listën e Votuesve

Parashtruesit e ankesës nga subjekti politik N.N, kanë pretenduar se familjes së kryetarit të nëndegës së pestë, X.X të subjektit politik N.N, prej 16 anëtarësh janë hequr nga vendvotimi në shkollën fillore “Jeronim De Rada” në Ferizaj ku kanë votuar gjithnjë dhe janë dërguar në një shkollë tjetër.

Parashtruesi i ankesës të njëjtit subjekt ka pretenduar se në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Ferizaj shumë votues të cilët më parë kanë votuar në një vendvotim, u janë ndërruar vendvotimet.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesit e ankesës se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor me rastin e ndrrimit të VV, andaj PZAP-i pas shqyrtimit të lëndës ka refuzuar ankesat e subjektit politik N.N dhe vendosi konform dispozitave ligjore neni 3 paragrafi 6 pika (c), neni 6.3 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe neni 118.1 të LZP-së,

Anr.95/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik N.N dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të ndërrimit të Qendrës së Votimit (QV) disa votuesve, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat Anr.95/2012 dhe Anr.96/2012 të datës 29.04.2012 të subjektit politik N.N, dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP, më datë 29.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 95/2012, nga subjekti politik N.N, me të cilën pretendohet se familja e kryetarit të nëndegës së pestë, X.X të subjektit politik N.N, prej 16 anëtarësh janë hequr nga vendvotimi në shkollën fillore “Jeronim De Rada” në Ferizaj ku kanë votuar gjithnjë dhe janë dërguar në një shkollë tjetër.

PZAP, më datë 29.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 96/2012, nga subjekti politik N.N, me të cilën pretendohet se në këto zgjedhjeve shumë votues të cilët më parë kanë votuar në një vendvotim, gjatë këtyre zgjedhjeve u janë ndërruar

vendvotimet. Kjo gjë, sipas parashtruesit të ankesës, është një dukuri e shpeshtë dhe është bërë me qëllim për ti dekurajuar votuesit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 3 parasheh:

6.3 "Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendosë ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato si kur të ishin një ankese".

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Pretendimet nga parashtruesi i ankesave, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë që do ta argumentonin se ju është bërë ndërrimi i Qendrave të Votimit (QV) personave në fjalë, si dhe nga pretendimet ankimore në fjalë nuk rezulton se personave në fjalë ju është mohuar e drejta për të votuar ashtu siç e parasheh neni 5 i LZP-së, prandaj në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së,

ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 95/2012 më datën 30.04.2012

Kryesuesi i Panelit / **Ymer Hoxha**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranoj kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Ankesën mund të paraqitini përmes Postës në Serbi Programi i Votimit përmes postes (p.p) 23, 18101 Niš 1.*

2013

VENDIMI Anr. 26/2013,

Refuzim i aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve

Parashtruesi i apelit **N.N** ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KQZ-së me nr. Protokoli 20131104020186 për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesi i apelit se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, andaj PZAP-i pas shqyrtimit gjeti se apeli është i parregullt dhe vendosi në kuptim të nenit 3.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, nenit 118.1 të LZP-së.

Anr.26/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e **N.N** me vendbanim **Sevojno – Višeslava Bugarinovča 016**, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 13.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si i parregullt apeli i **N.N** me vendbanim në rrugën Sevojno – Višeslava Bugarinovča 016, mbetet në fuqi vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 20131104020186.

Arsyetim

Më 11.10.2013 PZAP-i ka pranuar një apel nga **N.N** kundër vendimit të KQZ-së me Nr. Protokoli **20131104020186**, me të cilin është refuzuar aplikacioni i tij që të përfshihet në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

PZAP-i pasi që shqyrtoi rregullsinë e apelit gjeti se:

Apeli është i parregullt

PZAP-i, konstatoi se apel i parashtruar ndaj vendimit të lartpërmendur është i parregullt sepse nuk i plotëson kriteret në kuptim të nenit 3.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, andaj në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr. 26/2013 më datën **13.10.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Muharrem Shala**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranoj kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejt themelore. Ankesën mund të paraqitini përmes Postës në Serbi Programi i Votimit përmes postes (p.p) 23, 18101 Niš 1.*

VENDIMI Anr. 74/2013, Mosregjistrimi i Iniciativës Politike në regjistrin e partive politike në ZRPPC

Parashtruesi i apelit, nga X.X, në cilësinë e kryetarit të iniciativës politike N.N, ka paraqitur apel kundër vendimit të KQZ-së me nr. protokolli 480-2013 të datës 26.07.2013 për shkak të mos regjistrimit të iniciativës politike në regjistrin e partive politike..

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesi i apelit se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, cenimin e kushtetutshmërisë, aplikimin e gabuar të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), si dhe shkeljen e rregullave procedurale gjegjësisht Rregullën Zgjedhore të KQZ-së 01/2013.

PZAP-i pas shqyrtimit të lëndës refuzoi apelin si të pabazuar të subjektit politik N.N, andaj PZAP-i duke u bazuar në Rregullën Zgjedhore nr.1/2013, si dhe në nenin 118.1 të LZP-së dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Anr.74/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga X.X, në cilësinë e kryetarit të Iniciativës politike N.N, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 480/2013 të datës 26.07.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 31.07.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si i pabazuar apeli i X.X, në cilësinë e kryetarit të iniciativës politike N.N.

Arsyetim

Me datë 29.07.2013, PZAP-i ka pranuar një apel nga X.X, në cilësinë e kryetarit të iniciativës politike N.N, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 480/2013, të datës 26.07.2013, për shkak të mos regjistrimit të iniciativës politike N.N në regjistrin e partive politike. Parashtruesi i apelit në këtë rast thekson se KQZ ka bërë cenimin e kushtetutshmërisë, aplikimin e gabuar të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), si dhe shkeljen e rregullave procedurale gjegjësisht Rregullën Zgjedhore të KQZ-së 01/2013.

Me këtë rast parashtruesi i apelit kërkon që të anulohet vendimi i KQZ-së dhe të

miratohet kërkesa e iniciativës politike N.N për regjistrim, në regjistrin e partive politike dhe të detyrohet Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), të regjistroi iniciativën politike N.N sipas kërkesës së parashtruar.

PZAP me datën 30.07.2013, me shkresën me nr. 74/2/2013, kërkoi nga KQZ-ja të gjitha shkresat e lëndës që i kanë paraprirë marrjes së vendimit të ankimuar.

PZAP-i, pranoi nga KQZ-ja, shkresën me nr. protokolli 70/2013 të bashkangjitur me materialin e kërkuar, vërejtjet, dhe sugjerimet e ZRPPC-së, drejtuar N.N, rekomandimin drejtuar KQZ – së, lidhur me iniciativën politike N.N.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës gjeti se apelimi është i **pa bazuar**:

Nga shkresa nr. 61/2013 datës 05.07.2013, vërtetohet se ZRPPC i ka bërë këto vërejtje dhe sugjerime iniciativës politike N.N:

Për aktin e themelimit të iniciativës politike, për programin e iniciativës politike, për raportin financiar të iniciativës politike, për statutin e iniciativës politike, për simbolin e iniciativës politike. Iniciativa politike N.N ka pas afat qe brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit për marrjen e shkresës nga ZRPPC-ja, të plotësoj apo ndryshoj statutin, programin dhe simbolin.

Nga rekomandimi i ZRPPC-së drejtuar KQZ-së vërtetohet se Iniciativa Politike N.N, brenda periudhës së caktuar nga ZRPPC-ja me shkresën 61/2013 e datës 05.07.2013 nuk i ka sjell ndryshimet e statutit dhe programit por e ka sjell vetëm simbolin e ndryshuar.

Po ashtu edhe nga vendimi i KQZ-së me nr.480/2013 i datës 26.07.2013 vërtetohet se Iniciativa politike N.N nuk i ka përmbushur vërejtjet dhe sugjerimet nga ZRPPC, të cilat vërejtje dhe sugjerime kanë në harmoni me legjislacionin zgjedhor.

Pas administrimit të të gjitha shkresave PZAP-i konstatoi se iniciativa politike N.N nuk i ka përmbushur vërejtjet dhe sugjerimet e ZRPPC-së të cilat vërejtje kanë qenë të bazuar në Rregullën nr.1/2013, Për regjistrimin dhe Veprimin e Partive

Politike. Programi dhe Statuti i iniciativës politike N.N, siç ka vlerësuar KQZ-ja është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjet në fuqi dhe Rregullën Zgjedhore nr.1/2013.

Sepse edhe vetë parashtruesi i ankesës thekson se programi i kësaj iniciative politike është i krijuar mbështetur në katër shtylla, katër ligje dhe kushtetuta paraprake si: Kodin e Justinianit, Kanuni e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Kanunin e Lek Dukagjinit dhe ne Ligjin dhe Kushtetutën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Ndërsa pretendimi ankimor se është dashtë të vendos Zyra e jo KQZ-ja, nuk qëndron sepse sipas nenit 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr.1/2013, ZRPPC-ja vetëm i rekomandon KQZ-së lidhur me çështjet ndërsa KQZ-ja, është organ i autorizuar me ligj të vendos lidhur me regjistrimin apo mos regjistrimin e subjekteve politike siç edhe ka ndodhur me rastin konkret, kur KQZ-ja në mbledhjen me nr.38 të datës 26.07.2013, ka vendosur për refuzimin e regjistrimit të iniciativës politike N.N

Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu duke u bazuar në Rregullën Zgjedhore nr.1/2013, si dhe në nenin 118.1 të LZP-së dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 74/2013 më datën **31.07.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.109/2013, Tërheqjen nga lista si Kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës

Parashtresja e apelit, kandidatja nga subjekti politik N.N, F. I. ka paraqitur apel lidhur me tërheqjen nga lista e kandidatëve të certifikuar nga KQZ-ja.

Më këtë rast parashtresja e apelit ka kërkuar që të tërhiqet nga lista e kandidatëve nga radhët e subjektit politik N.N ti mundësohet kalimi në listën e subjektit politik X.X, andaj PZAP-i me këtë apel kishte vendosur të hudhë si të palejuar sipas dispozitave ligjore të nenit. 9.2 Të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe neni 115.1 të LZP.

Anr. 109/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e F. I., lidhur me tërheqjen nga lista si kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës në Shtërpce nga subjekti politik N.N, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2013, mori këtë:

VENDIM

HIDHET apeli si i palejueshëm i F. I., kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës në Shtërpce nga subjekti N.N

Arsyetim

PZAP-i me datën 20.09.2013, ka pranuar një apel nga F. I., kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës në Shtërpce nga subjekti politik N.N, me të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista për anëtare të Kuvendit Komunal, me propozim që PZAP-i të ja mundësoj kalimin në listën e kandidatëve të subjektit politik X.X pasi që kandidatja në fjalë i përket këtij subjekti politik.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i gjeti se apeli është i **palejuar**:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku

dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.09.2013. Andaj pala e cila ka parashtruar apel në PZAP nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. Me qenë se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, PZAP-i, vendosi se apeli është i palejuar prandaj duke u bazuar në nenin 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 109/2013 më datën **25.09.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Xhevdet Abazi**

Udhëzim Juridik: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.500/2013,

Fotografim i fletëvotimit gjatë votimit dhe parregullsi të ndryshme

Parashtruesi i ankesave nga subjekti politik N.N, ka pretenduar se gjate ditës së votimit në disa Këshilla të Vendvotimeve ka pasur parregullsi dhe shkelje të rregullave zgjedhore, ku disa votues kanë bërë fotografimin e votës dhe kanë votuar nga disa herë etj.

Më këtë rast parashtruesit e ankesave pretendojnë së në këto Këshilla të Vendvotimeve ka pasur parregullsi të shumta të cilat janë në kundërshtim me legjislacioni zgjedhor, prandaj PZAP-i për këto çështje ka vendosur konform nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të dispozitave ligjor të nenit 115.1 dhe 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) si në dispozitiv të këtij vendimi.

Anr. 500/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Ymer Hoxha, dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik N.N, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike (X.X) (Y.Y) (Z.Z) (M.M), ZKKZ dhe disa votuesve për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik N.N, me seli në Prishtinë: Anr.500/2013, Anr.501/2013, Anr.502/2013, Anr.503/2013, Anr.504/2013, Anr.506/2013, Anr.507/2013, Anr.509/2013, Anr.511/2013, Anr.512/2013, Anr.513/2013, Anr.515/2013, Anr.516/2013, Anr.518/2013, Anr.519/2013, Anr.522/2013, Anr. 523/2013, Anr.525/2013, Anr.526/2013, Anr.530/2013, Anr.532/2013, Anr.533/2013, Anr.535/2013, dhe Anr.536/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr.500/2013, Anr.501/2013, Anr.502/2013, Anr.503/2013, Anr.504/2013, Anr.506/2013, Anr.507/2013, Anr.509/2013, Anr.511/2013, Anr.512/2013, Anr.513/2013, Anr.515/2013, Anr.516/2013, Anr.518/2013, Anr.519/2013, Anr.522/2013, Anr. 523/2013, Anr.525/2013, Anr.526/2013, Anr.530/2013, Anr.532/2013, Anr.533/2013, Anr.535/2013, dhe Anr.536/2013 nga subjekti politik (N.N) me seli në Prishtinë, me te cilat pretendohet se gjatë ditës së votimit ka pasur parregullsi të natyrave të ndryshme si votim i dyfishtë, fotografim i votës, votim pa dokument valid, asistim pa leje gjatë votimit, thyerje të heshtjes zgjedhore si dhe premtim i shpërblimit financiar.

– Sipas ankesës Anr.500/2013, pretendohet se gjatë ditës votimit në QV nr.1633A një mbështetës i subjektit politik N.N ka bërë shkeljen e rregullave zgjedhore duke fotografuar votën e tij.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi për shkeljen e pretenduar.

– Sipas ankesës Anr.501/2013, pretendohet se në ditën e votimit një votues është parë duke bartur persona deri tek QV 2004 A. Me këtë rast është bërë shkelja e nenit 6.1 Rregullës 11/13 të KQZ-së.

– Sipas ankesës Anr.502/2013, pretendohet se në ditën e zgjedhjeve në QV 2714b/03d në fshatin Maxhun votuesi me emrin N.H ka tentuar të votoj dy herë.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi.

–Sipas ankesës Anr.503/2013, pretendohet se në QV në fshatin Sopniq– Rahovec kryesuesi i vendvotimit F.G, ka lejuar votimin e një personi i cili nuk ka poseduar dokument valid të identifikimit siç është e përcaktuar me ligj.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi

–Sipas ankesës Anr.504/2013, pretendohet se në QV 2702d/06d një person me emrin A.G në përcillje të një personi i cili shtirej se është person me nevoja të veçanta ka bërë përcjelljen e tij deri tek kutia e votimit edhe pse vëzhguesit e

subjektit politik N.N kanë kundërshtuar një gjë të tillë, e cila është e ndaluar me rregulla zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.506/2013, pretendohet se në QV 0423 D/01R në fshatin Përlepnice votuesi me emër E.H gjatë votimit ka fotografuar votën e tij, sipas parashtruesit të ankesës ky votues ka bërë shkeljen e Kodit Penal të Kosovës.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.507/2013, pretendohet se në QV shkolla fillore “Naim Frasheri” në Shtime disa votues kanë votuar për të dytën herë dhe një gjë të tillë e ka lejuar anëtar i KKZ-së A.D dhe A.Z edhe pse këta votues kanë pasur gishtërinjtë e spërkatur. Me veprim është kryer vepra penale nga neni 214 i Kodit Penal.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr. 509/2013, pretendohet se në QV 2305D/03R një person me emrin H.XH, punëtor social në komunën e Shtërpçës është parë nga dëshmitarët duke shpërblyer një votues me gjëra ushqimore për arsye të votimit të subjektit politik N.N. Me këtë është bërë shkelja e Kodit Penal dhe Kodit të Mirësjelljes.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi

– Sipas ankesës Anr. 511/2013, pretendohet se kandidati për asamble komunale V.SH nga radhët e subjektit politik (Y.Y) është parë duke votuar rreth orës 8 e 30, i cili ka qenë i shoqëruar nga një grua të moshës së vjetër i njëjti është parë disa orë më vonë në korridorin e shkollës. Me këtë është bërë shkelja e rregullës zgjedhore 11/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr. 512/2013, pretendohet se në QV 0901E-04R komisionari B.R nga radhët e subjektit politik Y.Y kishte votuar dy herë në këtë QV edhe pse komisionerët tjerë kishin reaguar për një gjë të tillë. Me këtë ka bërë shkelje të nenit 19.1 të rregullës zgjedhore 09/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi.

- Sipas ankesës Anr.513/2013, pretendohet se në lagjen Romajë-Prizren mbështetës të subjektit politik Y.Y kanë kishin thyer heshtjen parazgjedhore duke bredhur rrugëve të lagjes me veturë në të cilën kishin vendosur flamuj dhe logo të subjektit politik N.N-së. Me këtë kanë bërë shkeljen e dispozitës së nenit 7 të rregullës zgjedhore 09/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një foto.

- Sipas ankesave Anr.515/2013 dhe Anr.516/2013, pretendohet se në QV në fshatin Kqiq dyshohet se votuesja A.M kishte votuar dy herë sepse kishte shenja të sprejit në gisht. Me këtë pretendohet se është kryer vepra penale e përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

- Sipas ankesës Anr.518/2018, pretendohet se në QV 1817E VV 1 votuesi A.N nga Terrnava pas përfundimit të votimit kishte fotografuar votën e tij. Me këtë pretendohet se ka pasur shkelje të nenit 15 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore 09/2013 dhe nenit 89 par 4 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

- Sipas ankesë Anr.519/2013, pretendohet se në QV 1824E VV 08R një votues V.M ka fotografuar votën e tij. Me këtë ka bërë shkeljen e nenit 15 par 4 i Rregullës Zgjedhore 09/2013 dhe nenit 89 par 4 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

- Sipas ankesës Anr.522/2013, pretendohet se gjatë procesit të votimit në QV 1030D/02R është bërë një parregullsi ku kryesuesi i këtij vendvotimi, B.TH ka bërë nderimin e futjes së fletëvotimit nga kutia e votimit me kusht në atë të kuti të votimeve të rregullta, me këtë veprim të këtij kryesuesi është bërë shkelje e nenit 18 dhe 19 i Rregullës zgjedhore 09/2013 të KQZ-së dhe Kodit Penal të Kosovës neni 216 par 1 dhe 2.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

- Sipas ankesës Anr. 523/2013 pretendohet se në QV 1104B/09R një votues me

emrin LL.T ka votuar për herë të dytë me kusht pasi pretendohet se kishte votuar edhe ne shkollën "Anton Zako Çajupi" me këtë dyshohet se ka bërë shkeljen e Kodit Penal të Kosovës neni 216 par1.1 dhe 1.2.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.525/2013, pretendohet se ne QV 0205/C ne Gjakovë se komisionari nga radhët e subjektit politik (N.N) N.N në momentin kur një votues ka kryer procedurat paraprake të identifikimit në listën e votuesve i njëjti ka dëmtuar fletëvotimin duke shkoqur nga dengu bashkë me numrin serik. Kjo parregullsi është evidentuar edhe në librin e votimit 0205/C. Me këtë rast ka bërë shkelje të Kodit Penal neni 218 par 3 në lidhje me par 3 si dhe rregullën Zgjedhore 09/2013 neni 15 par 4.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.526/2013, pretendohet se ne QV 0402x/08R në Gjilan një votues me emrin N.N pasi ka votuar ka bërë fotografimin e votës së tij. Me këtë veprim ka kryer shkeljen e Kodit Penal neni 215 par 2 dhe dispozitat e nenit 15 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr. 530/2013, pretendohet se në shkollën fillore "Skënderbeu" në fshatin Vaganicë-Mitrovicë një person me emrin N.N pasi që ka votuar ka bërë fotografimin e tij. Me këtë veprim është bërë shkelja e nenit 15 par 4 Rregullës Zgjedhore 09/2013 dhe neni 89 par 4 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.532/2013, pretendohet se në QV 0403D/01R një votues me emrin N.N pasi ka votuar ka fotografuar votën e tij. Me këtë është bërë shkelja e nenit 15 par 4 i Rregullës Zgjedhore 09/2013 dhe neni 89 par 4 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.533/2013 në QV 3044A/01R votuesi N.N gjatë verifikimit të gishtërinjve është vërejtur se ky votues i kishte pasur gishtërinjtë e spërkatur gjë që dyshohet se i njëjti kishte votuar edhe me herët. Komisionerët ishin munduar

ta ndalojnë që të mos votoj por i njëjti kishe hyrë me dhunë. Me këtë rast është bere shkelje e nenit 216 të Kodit Penal të Kosovës.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.535/2013 në QV 1104R/04B në shkollën fillore “Ismail Qemali” Bajr – Mitrovicë, votuesja N.N pasi ka votuar ka fotografuar votën e tij. Me këtë rast është ber shkelje e nenit 15 paragrafi.4 i Rregullës Zgjedhore 09/2013 dhe nenit 89 par 4 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë prove si dëshmi.

– Sipas ankesës Anr.536/2013 pretendohet se në Rr “Xhelal Hajda” aktivistet e N.N-së kanë vendosur posterat e kandidatit për kryetar komune N.N nga radhët e subjektit politik N.N ku është thyer heshtja zgjedhore. Me këtë rast është ber shkelje e nenit 7 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-konstaton se pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik N.N, paraqitura në ankesa kundër subjekteve politike të përmendura në ankesa e lartcekura janë të pabazuara, nga shkak se nuk ka prova se subjektet e lartë përmendura kanë shkelur dispozitat ligjore në të cilat pretendohet në ankesat e sipërsënuara.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kur dhe në çfarë kohe kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, dhe pasi që ankesave të parashtruara nuk iu janë bashkangjitur prova bindëse që të argumentohet kryerja e shkeljeve të cekura, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 500/2013 më datën **06.11.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Xhevdet Abazi**

Këshill Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

VENDIMI Anr.537/2013, Përleshje fizike

Parashtuesi i ankesës nga subjekti politik N.N, ka pretenduar se A.H anëtari i Këshillit të Vendvotimit nr2 Q.V nr1810, ka bërë shkelje të rregullave zgjedhore duke e sulmuar anëtarin e KVV-së nga ky subjekt politik .

Më këtë rast pretendohet nga parashtuesi i ankesës së anëtari i Këshillit të Vendvotimit nr2 Q.V nr1810, ka shkelur legjislacionin zgjedhor, prandaj PZAP-i, ka vendosur për këtë çështje konform dispozitave ligjor të nenit 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika c) dhe neni 120 par. 3 pika d) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

A nr. 537/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik N.N dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik X.X, dega në Podujevë për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve në qytetin e Podujevës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik N.N dega në Podujevë.

II. Subjektit politik X.X dega në Podujeve i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi ndërsa **A.H** komisioner nga rradhët e subjektit politik X.X, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 6 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 04.11.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik N.N dega në Podujevë, në të cilën theksohet se me datën 03 nëntor 2013, në ora 16:00 në Vendvotimin nr2 të Q.V nr1810, komisioneri P.H nga subjekti politik (N.N) ka kërkuar nga kryesuesi i vendvotimit M.H nga subjekti politik (Y.Y) që të ketë parasysh për disa parregullsi në vendvotim si: të identifikohen të gjithë votuesit e pranishëm që

brenda ishin të shumtë në vendvotim, dhe papritmas A.H komisioner nga radhët e subjektit politik (X.X) iu është vërsulur duke e goditur personin P.H me grushte. Me rastin është marr Policia duke marr deklaratat e P.H dhe A.H në stacionin e policisë në Podujevë. N.M aktivisti i subjektit politik (N.N) është dëshmitarë okulare i cili gjendej në vendvotim për të votuar dhe e ka parë P.H e gjakosur në hundë dhe fytyrë dhe një situatë të tillë sipas dëshmitarit N.M, procedura e votimit ka vazhduar edhe pse brenda në vendvotim qëndronin edhe dy policë, numri identifikues i njërit polic në uniformë ishte 8327

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi të ndërmarr veprimet e nevojshme për këtë.

Në raportin e policisë të Kosovës me nr. 2013-AF-1586 të datës 04.11.2013 theksohet se me datën 03.11.2013 në fshatin LLapashtic komuna e Podujevës ka ndodhur një rast i pengimit të procesit zgjedhor në QV 1810e/02 ku komisionari nga subjekti politik (X.X) A.B ka goditur komisionarin e subjektit politik (N.N) P.H me të cilin ka filluar që ti rrjedh gjak nga hundët ku me këtë rast ka ndërhyrë policia e cila ishte në atë qendër për sigurimin e procesit zgjedhor dhe duke i ndaluar personat e lartcekur. Në raportin e policisë së Kosovës theksohet se në stacionin policor viktimës ju dha ndihma mjekësore dhe u intervistua në prezencën e avokatit. Po ashtu gjatë kohës së zhvillimit të hetimeve në lidhje me rastin ka qenë edhe prokurori i rastit A.H ku me vendim të tij i dyshuari është ndaluar në qendrën e mbajtjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore janë të bazuara pasi që A.H komisioner nga radhët e subjektit politik (X.X) në QV 1810e/02 ka sulmuar anëtarin e subjektit politik (N.N) P.H me ç' rast i ka shkaktuar lëndime trupore. Kjo vërtetohet edhe përmes raportit policor 2013-AF-1586 të datës 04.11.2013 në të cilën e përshkruan në mënyrë të detajuar gjithë incidentin e ndodhur në këtë QV ku me ç' rast theksohet se gjatë ditës së zgjedhjeve ka ndodhur një incident ku A.H ka sulmuar P.H duke i shkaktuar lëndime trupore. PZAP-i duke vendosur për gjobën ka marrë si rrethanë rënduese se shkelja ka të bëjë me shkeljen e dispozitave ligjore të LZZP-së, ndërsa sa i përket ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë se

shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e votimit. Prandaj nga arsyet e lartcekura me qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuara më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120.1 pika c) dhe 120.3 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 537/2013 më datën **07.11.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Hasan Shala**

Këshillë Juridik: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjopa e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*

VENDIMI Anr.594/2013,

Thyerja e heshtjes zgjedhore–Postimi i një statusi dhe publikimi i një fotografie në rrjetin social Facebook

Parashtuesi i ankesës N.N. ka pretenduar se X.X. ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një statusi dhe publikimin e një fotografie në rrjetin social Facebook.

Më këtë rast pretendohet nga parashtuesi i ankesës se është bërë shkelje e nenit veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së. PZAP, pas shqyrtimit të lëndës, vendosi të miratojë si të bazuar ankesën, në kuptim të nenit, 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së.

Anr. 594/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e N.N. paraqitur kundër X.X. për shkak të bërjes së fushatës gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e N.N. kështu që X.X. i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga N.N. në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013 P.D. kandidate për asamble komunale në Prishtinë nga X.X. ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një statusi dhe publikimin e një fotografie, andaj me këtë rast sipas parashtresës të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi X.X. me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00. PZAP-

i sipas afatit të caktuar pranoi përgjigjen në ankesë nga X.X. e në të cilën theksohet fotografia e bashkangjitur ankesës nuk mund ta provojë autorësinë e postimit të fotografisë si dhe pronësinë ndaj llogarisë në rrjetin facebook të kandidatës së X.X. Po ashtu sipas X.X. shihet qartë se në fotografimin e ofruar si provë përfund emrit të postuesit dhe kohës së postimit ku është 2 orë më parë është edhe një etiketim i ngjitur ku është shënuar data 3 nëntor 2013 ora 13:56 që aludohet se ky postim është postuar me 3 nëntor në ora 11:56 duke pasur se dy orë më parë është postuar para se ankuesi të ishte në dijeni lidhur me këtë postim, andaj kjo etiketë në asnjë mënyrë nuk e tregon se koha e postimit është autentike. Andaj mungesa e të provuarit të identitetit të pronësisë mbi llogarinë dhe kohës së postimit e bënë këtë ankesë si të pabazuar dhe si e tillë duhet ta hedhë poshtë. Me këtë rast X.X. kërkon nga PZAP-i që ta merr parasysht se çështja e shtrirjes së legjislacionit në këtë sferë ku serverët e kompanisë facebook ku procedohen të dhënat softuerike gjendet në një shtet tjetër që në aspektin territorial legjislacioni i Republikës së Kosovës nuk vepron në hapësirë dhe se kjo është element kryesor i kualifikimit të veprimit të ligjit në hapësirë, kohë dhe ndaj personit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës shihet qartë se si kandidatja për asamble komunale në Prishtinë nga X.X., P.D. me datën 03 nëntor gjatë ditës së zgjedhjeve ka bërë postimin e fotografisë me karakter zgjedhor me qëllim të favorizimit për tu votuar kandidati i X.X. veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së i cili përcakton që njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mështetesve ose kandidateve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfardo mënyrë.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysht faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i, vlerëson se X.X. në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj mbi këtë bazë si dhe në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me neni 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 594/2013 më datën **07.11.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Hasan Shala**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.716/2013,

Shpallja e rezultateve preliminare

Parashtuesi i ankesës nga subjekti politik **NN**, B.A. kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, ka pretenduar se ka pas keqpërdorim të votave gjatë numërimit të fletëvotimeve si dhe favorizim të personave tjerë brenda listës së kandidatëve të po të njejtit subjekt politik.

Më këtë rast pretendohet nga parashtuesi i ankesës se komisioneret e subjektit politik **NN**, kanë bërë manipulime të ndryshme në Qendrat e Votimit në të cilat kanë qenë të emëruar si komisioner, gjë që është në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor.

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është përfundimtar.

A nr. 716/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e YY, kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Lipjan nga subjekti politik **NN**, paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntor 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

VENDIM

HIDHET si e palejueshme ankesa e YY, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunalë në Lipjan nga subjekti politik **NN**.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga **YY**, kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Lipjan nga subjekti politik **NN**, në të cilën pretendohet se ka pas keqpërdorim të votave gjatë numërimit, favorizim i personave tjerë brenda listës tonë, komisioneret e subjektit politik **NN**, për Qendrat e Vendvotimeve (QV) si më poshtë: 1304e.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se *“Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj”*. Në rastin konkret ankesa është parashtuar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet”* dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”*, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 716/2013 më datën **08.11.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Xhevdet Abazi**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

VENDIMI Anr.931/2013,

Anulim dhe Rivotim

Parashtruesi i ankesës nga subjekti politik NN dega në Zveçan, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se në disa QV dhe VV në Zveçan, se është shkelur Ligji për Zgjedhjet Lokale dhe Ligji për Zgjedhjet Përgjithshme të Kosovës (LZP) të cilat shkelje kanë ndikuar në rregullsinë e zgjedhjeve, të drejtën e qytetareve të marrin pjesë në këto zgjedhje dhe të shprehin vullnetin e tyre,

PZAP-I konstatoi se ka pasur shkelje të legjislacionit zgjedhor dhe pjesërisht ka miratuar ankën dhe ka Urdhëruar KQZ-në që të përsërisë votimit në (QV) 2901B/02R/05R dhe QV 2913B/01R, komuna e Zveçanit.

A nr. 931/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazic anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e NN nga YY dega në Zveçan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të publikimit të rezultatit përfundimtar, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet pjesërisht ankesa e NN nga YY dega në Zveçan, sa i përket pretendimeve të ankesës lidhur me Qendrat e Votimit (QV) 2901B/02R/05R dhe QV 2913B/01R.

II. URDHËROHET, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të përsërisë votimit (QV) 2901B/02R/05R dhe QV 2913B/01R, komuna e Zveçanit.

III. Ndërsa pjesa tjetër e ankesës lidhur me pretendimet të cilat nuk përfshihen në pikën I të këtij dispozitivi refuzohen si të pabazuara.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 15.11.2013, ka pranuar një ankesë NN nga YY dega në Zveçan me të cilën pretendohet se është shkelur Ligji për Zgjedhjet Lokale dhe Ligji për Zgjedhjet Përgjithshme të Kosovës (LZP) të cilat shkelje kanë ndikuar në rregullsinë e zgjedhjeve, të drejtën e qytetareve të marrin pjesë në këto zgjedhje dhe të shprehin vullnetin e tyre, po ashtu kanë ndikuar sipas parashtruesit të ankesës edhe në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve dhe në saktësinë e këtyre rezultateve si në vijim:

1. Parashtruesi i ankesës thekson se janë paralajmëruar nga KQZ-ja se për shkak parregullsive zgjedhore në disa vende në komunën e Zveçanit zgjedhjet do të anulohet, por nuk do të përsëriten. Ky

qëndrim nga KQZ-ja për ne është i pakuptimtë sepse është në kundërshtim me ligjin, dhe është në kundërshtim me vet logjikën. Nga rezultatet përfundimtare për kryetar komune, ku rezultatet janë të ngjashme edhe për deputet, mund të shihet se për njërin nga kandidatet kanë votuar 480 votues, e për tjetrin 354 votues. Në këtë komunë nuk ka pas kandidatë tjerë. Kjo tregon se kanë votuar gjithsejtë 844 votues. Në vendvotimet ku janë anuluar zgjedhjet: në VV 2901B/01R kanë votuar 950 votues, në VV 2901B/05R kanë votuar 926 votues, dhe në VV 2913B/01R kanë votuar 719 njerëz. Kjo do të thotë se secili nga këto vendvotime ka mjaftueshëm votues të cilit mund të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve dhe do mund ta ndërroheshin në tersi ato rezultate. Diferenca ndërmjet dy kandidatëve është vetëm 126 vota, ndërsa në këto tri VV ekzistojnë gjithsejtë 2595 votues, dhe është absolutisht e papranueshme që KQZ-ja, t'i anulojë zgjedhjet e të mos t'i organizojë zgjedhjet e reja. Këtu ka të bëjë me një të katërtën e qytetareve me drejt vote në tërë komunën, dhe është domosdoshme që zgjedhjet të përsëriten sepse nuk ka të bëjë me një numër të vogël të votuesve i cili nuk do të ndikonte në rezultatet përfundimtare.

2. Është shumë e qartë për të gjithë ata të cilit objektivisht vendosin për këto çështje se gati 1000 votues në secilin vendvotim mund ta ndikojnë në rezultatet përfundimtare dhe se votuesve të cilët nuk kanë faj pse janë anuluar zgjedhjet t'i jepet mundësia dhe shansi i dytë të votojnë përsëri dhe që vota e tyre të vlerësohet e jo të anulohet për shkak fajit e të tjerëve. Jemi të informuar se situata e njëjte është edhe në VV Zveçan 1 dhe Zveçan 4, gjegjësisht 2901B/01R dhe 2901B/04R, ku mungojnë listat e votuesve me nënshkrimet e votuesve të cilët kanë votuar. Në këto vendvotime votojnë 946, respektivisht 935 njerëz, dhe gjithsejtë janë 1881 votues. Kur i shtohet këtij numri edhe numri i votuesve nga vendet ku janë anuluar zgjedhjet, fitojmë një numër prej 4476 votues, që është 50 %, nga numri i votuesve të regjistruar në komunën e Zveçanit.

3. Deri tek anulimi i zgjedhjeve në këto vendvotime ka ardhur për arsye se në ditën e zgjedhjeve me 03 nëntor, ka pas shumë parregullsi, por për një parregullsi më të madhe ka qenë përgjegjës OSBE-ja, të cilët janë larguar nga vendvotimet pa pasur ndonjë arsye të fortë, në ora 18:00 e ato VV ishin dashtë jenë të hapur deri në ora

19:00, në bazë të nenit 88.1 të LZP-së. Kështu është shkelur një nen shumë i rëndësishëm i LZP-së dhe është mohuar e drejta për të votuar për të gjithë qytetaret e Zveçanit të cilët nuk kanë mundur të vijjnë më herët apo të cilët kanë dashtë të votojnë më vonë, por është shkelur edhe Kushtetuta e Kosovës ku më nenin 3 parashihet barazia e të gjithë qytetareve. Në këtë rast për ata qytetarë të cilët kanë zgjedhur të votojnë më vonë, por brenda periudhës kohore të parapare me ligj, nuk kanë mundur ta realizojnë drejtën e tyre, dhe pa fajin e tyre janë vënë në një pozite pavoritshme dhe në një pozite jo barazie e cila nuk lejohet me Kushtetutë. Është shkelur edhe neni 89.2 i LZP-së i cili thotë se askush nuk mund të ndalojë votuesin ta përdor drejtën e tij për të votuar, ndërsa në këtë rast iu është ndaluar kjo drejta nga OSBE-ja dhe nga anëtarët e KVV-ve të cilët kanë ikur nga vendvotimet para kohës së parashikuar me ligj për kohëzgjatjen e votimit.

4. Është shkelur neni 93.2 i LZP-së i cili parasheh se pasi që votuesi i fundit ka votuar në kohën e mbylljes së VV-së, kryesuesi i KVV-së e mbyll VV-në, e mbyll kutinë e votimit në prezencë të vëzhguesve dhe shënon kohën e saktë e mbylljes së Librit e Votimeve. Asgjë nga këto nuk janë bërë, ndërsa në të gjitha kutitë e votimit kanë munguar bllokbato dhe vullat.

5. Këto incidente nuk janë fare të shënuar në librin e votimit ku shënohen të gjitha ngjarjet kryesore, në bazë të nenit 94.1.

6. Largimi i parakohshëm i OSBE-së dhe anëtareve tjerë nga vendvotimet ka shkaktuar një parregullsi tjetër serioze. Materiali zgjedhor, kutitë e votimit, listat e votuesve, fletëvotimet, ditarët dhe procesverbalet nga votimet, të gjitha këto janë lënë pa kurrfarë mbikëqyrjeje së paku për dy ore, nga ora 18:00 deri ora 20:00, ndërsa në fshatrat edhe shumë më gjatë, në disa vende edhe deri në mesnatë, kur kanë ardhur pjesëtarët e policisë t'i marrin këto materiale.

7. Transportimi i materialit zgjedhor dhe kompletimi i tij kanë qenë jashtë mundësisë për subjektet politike që ta mbikëqyrin dhe të mbledhin informata, sepse i tërë procesi ka qenë shumë jo transparent. Askush nuk ka ditur se kush e ka marrë materialin, ku

ruhet ky material dhe a është dikush duke u kujdesur fare për këtë material.

8. Rezultatet e numërimeve nga VV-të, 12 ditë pas zgjedhjeve ende nuk janë publikuar në qendrat e votimit nga ana e secilit kryesues e këtyre qendrave, edhe pse janë të obliguar në bazë të nenit 102.3 të LZP-së.

9. Për këtë arsye ne ende nuk e dimë, edhe pse i kemi dëgjuar disa thashethemet, që gjatë numërimit e votave për komunën e Zveçanit është vërtetuar se mungon një numër i madh i materialit zgjedhor. Ne besojmë se kjo informatë është e vërtetë sepse edhe vet procesi i votimit me 03 nëntor dhe mënyra me cilën është përfunduar dhunshëm votimi para përfundimit të kohës së votimit, tregojnë se procedurat ligjore nuk janë respektuar. Jemi informuar se në VV "Zveçan 1", "Zveçan 2", "Zveçan 4", "Zveçan 5" dhe "Zerovnica 1" mungojnë lista e votuesve me shënimet e votuesve të cilët kanë shfrytëzuar drejtën e tyre për të votuar, dhe kështu është totalisht e panjohur se sa votues kanë votuar në këto VV. Përveç listës përfundimtare e votuesve, mungon edhe Libri i votimit, gjë e cila e bën pamundur vërtetimin e rezultateve të sakta të zgjedhjeve dhe jep arsye për të dyshuar dhe kontestuar.

10. Edhe pse janë përmendur 5 VV në këtë ankesë, ankesa ka të bëjë më të gjitha vendvotimet në komunën e Zveçanit ku kjo mungesa zbulohet, dhe posaçërisht nëse, sikurse në këto vendvotime, numri i fletëvotimeve të përdorura është më i madh se numri i personave të nënshkruar në listën e votuesve që kanë votuar.

11. Nëse zgjedhjet janë të anuluar në disa vendvotime, dhe nuk mbahet rivotimi, krijohet një situatë absurde ku numri i këshilltareve nga partitë shqiptare do të rritet jo proporcionalisht sepse numri i votuesve të tyre do të jetë i pa prekur, kurse numri i votuesve të cilët kanë votuar në total, por vetëm numri i Serbeve, do të zvogëlohet. Kështu do të rrezikohet parimi i kushtetutës për barazi të qytetareve sepse subjektet politike shqiptare do të jenë të përfaqësuara jo proporcionalisht. Nëse këto parti kanë fituar 200 vota nga totali i 1200 votave, është e qartë se e kanë fituar një të gjashtën e votave. Por nëse totali është 800 vota, nga të cilat 200 vota janë prapë të shqiptareve, kjo është gati dyfishimi i përqindjes së tyre.

Ne bazë të thënieve të prezantuara më lartë parashtuesi i ankesës kërkonë që për të gjitha vendvotimet e kontestuara në komunën e Zveçanit, për të cilat nuk ekzistojnë apo nuk janë gjetur Librat e Votimit, LPV-të apo listat e votuesve apo edhe çfarëdo materiali tjetër i domosdoshëm, dhe në ato vende ku është numri i fletëvotimeve të përdorura më i madh se numri i qytetareve të cilët kanë votuar, propozon që të anulohen zgjedhjet dhe të caktohet data kur do të përsëriten zgjedhjet në këto vende.

KQZ-ja me Vendimin e datës 11.11.2013 me nr. 1612/2013, e ka miratuar rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve (QNR), me të cilin vendim nuk është përfshi në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, numri i fletëvotimeve në QV2901B/02R/05R në komunën e Zveçanit, për shkak se kanë munguar Listat Përfundimtare të Votuesve (LPV).

KQZ-ja me Vendimin e datës 14.11.2013 me nr. 1822/2013, e ka miratuar rekomandimin QNR-së, me të cilin vendim nuk është përfshi në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, numri i fletëvotimeve në QV2913B/01R në komunën e Zveçanit, për shkak se ka munguar LPV-ja.

PZAP-i ne bazë të nenit 117.2 të LZP-së, ka shqyrtuar dhe hetuar pretendimet ankimore, provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë e tyre reciproke si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i, konstatoi se mos përfishrja në rezultatet përfundimtare të votimit në QV 2901B/02R/05R dhe QV2913B/01R dhe mos organizimi i rivotimit lidhur me këto QV nga ana e KQZ-së është i pa drejt, ngase me rastin e votimit në këto Qendra të Votimeve janë bërë shkelje siç janë theksuar edhe në ankesë si mbyllja para kohës e QV-ve, siguria e materialit zgjedhore, mungesa e Librave Përfundimtare të Votimit (LPV) e që janë bazë për anulim e këtyre votimeve dhe që janë bazë për përsëritjen votimit në QV-të e theksuara si në pikën -I- të këtij dispozitivi.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me refuzimin e ankesës si në pikën -III- të dispozitivit PZAP konstaton se lidhur me këto pretendime ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të vërtetohet pretendimet ankimore.

Andaj, bazuar në nenet 115.1, 117.2, 117.3, 118.1 lidhur me nenin 120.1 pika "b" të LZP-së PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 931/2013 më datën **18.11.2013**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

Këshillë Juridike: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

2014

VENDIMI Anr.27/2014, Mosdeklarim i Raportit Financiar

ZRPPC ka paraqitur ankesë kundër N N kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013 në Komuna e Shtimes, për shkak se nuk ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar në këtë institucion, i cili raport kërkohet në bazë të Nenit 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 7.6 të Rregullës Zgjedhore nr.12/2013

PZAP-i ka gjatë shqyrtimit të rastit ka gjetur se Raporti Financiar nuk është dorëzuar në ZRPPC-KQZ nga kandidati i lartëcekur gjë që ka bërë shkeljen e rregullave zgjedhore, kështu që miratoi ankesën e ZRPPC-së

A nr. 27/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) – KQZ, paraqitur kundër N N kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013 nga Komuna e Shtimes rr. Migjeni, për shkak të mosdorëzimit të Raportit Financiar të Shpenzimit të Fushatës Zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 12.03.2014, mori këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) KQZ, kështu që kandidatit të pavarur N N, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë nga ZRPPC të KQZ-së në të cilën theksohet se **N N** kandidati i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013, nuk e ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar në këtë institucion, i cili kërkohet në bazë të Nenit 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 7.6 të Rregullës Zgjedhore nr.12/2013

Parashtruesi i ankesës vërteton se N N nuk e ka sjell Raportin Financiar, që ka qenë deri më 18 Dhjetor 2013 për Raundin e parë (I).

PZAP-i, e informoi N N, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 10.03.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij

subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.03.2014, në ora 10:00

PZAP nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga **NN**

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, PZAP-i gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Neni 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.*

Në këtë kontekst, kandidati i pavarur **NN** ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për Raundin e Parë (I), jo më vonë se 18 Dhjetor 2013 – gjë që nuk ka ndodhur, prandaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore janë të bazuara.

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjëbajtjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në ndonjë palë zgjedhje në të kaluarën.

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se kandidati në fjalë ka rënë në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 1 të LZP-së, për shkak se nuk e ka dorëzuar raportin e financiar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore siç kërkohet më dispozitën e lartcekur. PZAP-i ka marr si rrethanë lehtësuese faktin se kandidati në fjalë ka marr pjesë për herë të parë në zgjedhjet lokale të vitit 2013, ndërsa si rrethanë rënduese ka marr parasysh faktin se kandidati në fjalë nuk e ka dorëzuar raportin e publikimit financiar sipas afatit të paraparë ligjor.

Për lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i vendosi duke u bazuar në nenin 120 paragrafi 1, pika c të LZP-së, në të cilin specifikohet se: *“Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e Rregullave Zgjedhore të KQZ-së mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro (€50,000)”*.

Andaj, bazuar nga arsyet e theksuar më lart dhe bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP, në të cilin parashihet se: *PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet*, PZAP-i vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 27/2014 më datën **12.03.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

VENDIMI Anr.75/2014, Ndikim tek votuesit përmes shpërblimit për të votuar subjektin politik

Parashtruesi i ankesës N.N. pretendon se subjekti politik X.X. ka ndikuar tek votuesit përmes shpërblimeve financiare që të votojnë subjektin e caktuar politik, para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik X.X. ka bërë shkeljen e Kodit Penal të Kosovës (KPK), Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Financimin e subjekteve politike.

PZAP-i, lidhur me këtë rast, vendosi të hedhë poshtë ankesën si të palejuar, ndërsa për pjesën tjetër të pretendimeve PZAP-i, shpallet inkompetent, në kuptim të nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së,

A nr. 75/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e N.N. dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik X.X. dega në Prishtinë, për shkak të fushatës zgjedhore dhe ndikimit tek votuesit përmes shpërblimit që të votojnë për subjektin e tij politik, para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen më 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2014, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e N.N. lidhur me pretendimet për fillimin fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë, ndërsa sa i përket ekzistimit të pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesë përkitazi me përgjegjësinë penale, PZAP-i shpallet **inkompetent**.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 24.05.2014, ka pranuar një ankesë nga N.N. dega në Prishtinë, me të cilin theksohet kryeministri i Kosovës H.TH. në faqen zyrtare të subjektit të tij politik X.X. me titull "Misioni i Ri" ka publikuar një postim në të cilin thuhet se subjekti i tij politik ka nisur një garë ku aplikuesit mund të fitojnë nga një "Ipad", dhe duke i ftuar qytetarët që të marrin pjesë në promovimin e platformës së tyre politike të Misionit të Ri. Më tutje sipas parashtruesit të ankesës kryeministri i Kosovës fton që të bëhen foto para një panoje të Misionit të Ri të vendosur në qytet ku më pas ajo foto të ngarkohet në seksionin e fotove dhe se gjatë procesit të ngarkimit duhet ta përzgjidhni tagun "Misioni i Ri Selfie". Sipas parashtruesit të ankesës Kryeministri i Kosovës fton që garuesi apo fotoja e të cilit do të merr

numërim më të madh të votave deri me datën 26 Maj në ora 23:59 do të fitoj një "iPad", ku fituesi do të kontaktohet përmes email-it ose telefonit.

Me këtë veprim sipas parashtresit të ankesës, H.TH. ka bërë shkeljen e Kodit Penal të Kosovës (KPK), Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Financimin e subjekteve politike pasi që veprimet e tilla sipas parashtresit të ankesës konsiderohen si ndikim tek votuesit nëpërmes shpërblimit financiar dhe keqpërdorimit të varësisë ekonomike të votuesve duke kërkuar nga ata që të votojnë në mënyrë të caktuar, veprime këto të kundërligjshme sipas nenit 213 të Kodit Penal të Kosovës.

Parashtresi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografën e publikuar së bashku me postimin nga faqja zyrtare e kryeministrit e projektuar nga subjekti politik X.X. si dhe vegzat ku është bërë publikimi i tyre në faqen e saj.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

- Ankesa është e palejuar lidhur me pretendimet ankimore të fillimi të fushatës zgjedhore e para datës së caktuar për fushatë zgjedhore,
- Ndërsa sa i përket ekzistimit të pretendimeve ankimore përkitazi me përgjegjësinë penale PZAP-i, shpallet inkompetent.

Sipas vendimit të KQZ-së me nr. protokolli 823/2014 të datës 08.05.2014, Fushata Zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillon nga data 28.05.2014 dhe zgjat deri më datën 06.06.2014, ndërsa dispozitat ligjore të LZP-së konkretisht neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, andaj PZAP-i duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese lidhur me bërjen e fushatës zgjedhore janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore lidhur me fillimin i e fushatës para datës së caktuar për fushatë janë të palejuara ngase për këto veprime sipas LZP-së nuk parashihet ndërmarrja e masave ndëshkuese.

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës se ka pasur

shkelje të Kodit Penal të Kosovës, duke ndikuar tek votuesit përmes shpërblimeve financiare që të votojnë subjektin e caktuar politik, PZAP-i, në mbështetje të dispozitave ligjore të cilat e përcaktojnë juridiksionin e tij shpallet inkompetent, andaj lidhur me këtë ju udhëzon që ti drejtoheni organeve kompetente për ndjekje penale.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 75/2014 më datën **26.05.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

Këshillë Juridike: PZAP, nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.79/2014,

Ndalim i publikimit të posterave promovues B2

Parashtuesi i apelit Koalicioni N.N. kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 1128/2014 me të cilin është bërë ndalimi i publikimit të posterave promovues. të madhësisë B2.

Më këtë rast pretendohet nga parashtuesi i apelit se ky vendim është në kundërshtim me nenin 44.1 të LZP-së, prandaj PZAP, pas shqyrtimit të apelit ka vendosur të aprovojë apelin dhe të anulojë vendimin e KQZ-së, konform dispozitave ligjore të nenit 44 par. 1 pika (b) nenit 118 paragrafi 1 të LZP-se dhe nenin 209 pika (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK)

Anr. 79/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Koalicionit N.N. në Prizren, paraqitur kundër Vendimit nr. 1128/2014 të dt. 27.05.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Prishtinë, për shkak të lidhur me ndalimin e publikimit të posterave promovues, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 29.05.2014, mori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET apeli i Koalicionit N.N. si i bazuar.

II. ANULOHET, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 1128/2014 i datës 27.05.2014.

Arsyetim

Me datën 27.05.2014, PZAP-i, ka pranuar një apel nga Koalicionit N.N. në të cilin pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në takimin e saj të radhës të mbajtur me dt. 27.05.2014, ka marr vendim për ndalimin e publikimit të posterave promovues të madhësisë B2, në vendet e shënuara për reklamimin e partive politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Ky vendim i KQZ-së sipas parashtuesit të apelit është në kundërshtim me nenin 44.1 të LZP-së dhe ndërhyjnë në të drejtat e subjekteve politike dhe në reklamimin e tyre gjë që është e garantuar me këtë ligj. Me këtë rast, shton se janë duke u dëmtuar nga ky ndalim i reklamimit sepse mënyrat e tjera të reklamimit kanë kosto të lartë të shpenzimeve dhe se nuk mundën ti përballojnë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 28.05.2014, për apelin që është bërë ndaj vendimit të saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit në fjalë deri më datë 29.05.2014 në ora 10:00. PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja, në të cilën theksohet se me datën 27.09.2013 KQZ-ja ka marr Vendim për të ndaluar publikimin e posterave promovues me qëllim për të parandaluar problemet eventuale në mes të subjekteve politike lidhur me hapësirat publike për vendosjen e posterave si dhe me qëllim të ruajtjes së ambientit në hapësirat publike.

Më tej në përgjigje në ankesë nga KQZ-ja theksohet se pohimi i Koalicionit N.N. nuk qëndron, pasi që me asnjë akt ligjor dhe nënligjor nuk janë specifikuar hapësirat për vendosjen e posterave promovues.

Mirëpo, me Vendimin e saj KQZ ka ndaluar vetëm publikimin e posterave promovues të formatit B2 që nuk ka të bëjë me ndalimin e formave tjera.

PZAP-i, pasi analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i bazuar

Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013 "Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike", përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Në kuptim të nenin 44 par. 1 pika (b) të LZP-së, sipas kushteve të saktësuar në Kodin e Mirësjelljes gjatë Periudhës së Fushatës Zgjedhore, subjektet politike kanë të drejtë të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe çfarëdo çofshin ato pa ndonjë kufizim përkitazi me madhësisë (dimensioneve të tyre), reklamave dhe materialeve tjera në një fushatë zgjedhore.

Me vendimin e ankimuar është vepruara në kundërshtimin më këtë dispozitë ligjore, dhe për më tepër KQZ-ja me asnjë vendim të saj, subjekteve politike apo garuesve në zgjedhje nuk mund t'ua kufizoj apo ndaloj të drejtat të cilat atyre ju takojnë sipas ligjit.

Nga kjo del se me asnjë dispozitë të LZP-së e as me Rregulla Zgjedhore nuk parashihet ndalimi i publikimit të posterave promovues "B2" të kandidatëve të cilët janë të certifikuar për të marr pjesë në garën për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvend të Republikës së Kosovës.

Andaj duke u bazuar ne arsyet e lartcekura, si dhe ne pajtim me dispozitat e cituara, ne kuptim te nenit 118 paragrafi 1 te LZP-se dhe lidhur me nenin 209 pika (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 79/2014 më datën **29.05.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Hasan Shala**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.185/2014,

Shfrytëzimi i shërbyesve publik për zhvillimin e fushatës zgjedhore

Parashtruesi i ankesës N.N. ka pretenduar se subjekti politik X.X. ka sponsorizuar publikimin dhe emetimin e video klipit promovues duke i shfrytëzuar shërbyesit publik.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesi i ankesës se është bërë shkelje e dispozitave ligjore të nenit 35.2 të LZP-së dhe nenit 6.2 të Rregullës 11/2013 të KQZ-së.

PZAP, pas shqyrtimit të lëndës vendosi të miratojë si të bazuar ankesën në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, si në dispozitiv të vendimit.

Anr. 185/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e N.N. paraqitur kundër subjektit politik X.X. për shkak të shfrytëzimit të shërbyesve publik për zhvillimin e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2014, mori këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e N.N. kështu që subjektit politik X.X. i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 7100 (shtatë mijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 05.06.2014 ka pranuar një ankesë nga N.N. në të cilën theksohet se me datën 04.06.2014 në video arkivin YouTube dhe në portalin informativ Gazeta Express, subjekti politik X.X. ka sponsorizuar publikimin dhe emetimin e video klipit promovues duke i shfrytëzuar shërbyesit publik ku në video klipin i cili mban akronimin e subjektit politik X.X. dhe të fushatës së quajtur me emrin "Misioni i Ri" shihen zyrtarët e Doganave të Kosovës dhe një mësimdhënëse duke dhënë deklaratë në favor të mesazhit promovues të video klipit të subjektit politik X.X. Andaj me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik X.X. me video materialin e sponsorizuar dhe të emituar publikisht ka shfrytëzuar shërbyesit publik veprime këto që sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me nenin 35.2 të LZP-së dhe nenit 6.2 të Rregullës 11/2013 të KQZ-së. Si dëshmi parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD me video klipin e incizuar me atë për të cilin pretendon në ankesë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik X.X. për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik X.X. në të cilën theksohet se nga spoti në fjalë nuk ka asnjë dëshmi që kryetari i subjektit politik X.X. H.TH. bënë thirrje për ta votuar subjektin politik X.X. por se në cilësinë e kryeministrit në detyrë gjatë kësaj periudhe ka promovuar të arriturat e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe jo shfrytëzimin e shërbyesve civil ashtu siç pretendon pala ankuese, pasi që shërbyesit civil nuk bëjnë thirrje për votim të subjektit politik X.X. por se ata thjesht tregojnë ngritjen e pagave dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe familjeve të tyre.

Veprimet e Ndalura nga Shërbyesit Publik – përcaktohen bazuar në Nenin 35.2 të LZP-së dhe Nenin 6.2 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 në të cilat specifikohet se :

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesit publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës dhe nga video incizimi i bërë rezulton dhe shihet qartë se si subjekti politik X.X. në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 35.2 të LZP-së, ka shfrytëzuar dhe ka inkurajuar nëpunësit publik, për të bërë fushatë nëpërmjet tyre duke proklamuar rritjen e pagave të bëra ndaj tyre, krejt kjo me qëllim të përfitimit të votuesve, promovimit dhe të përkrahjes për subjektin politik X.X. veprime këto të kundërligjshme me dispozitën e lartpërmendur ligjore si dhe me rregullat zgjedhore në fuqi.

Bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c), të LZP-së, përcaktohet çart se në rast se ka ndodhur shkelja e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, PZAP-i mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në lartësi deri në 50,000 euro. Sipas Rregullës Nr. 01/2012 për *"Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave"*, neni 5 par. 2 të PZAP-it, specifikohet se *"gjatë periudhës së fushatës zgjedhore subjektit politik i ndalohet inkurajimi ose përfitimi nga shërbyesit publik duke përdorur pozitën publike të tij ose të saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik dhe se subjekti politik që është i përfaqësuar në kuvendin e Republikës së Kosovës për veprimet e tilla dënohet më gjobë nga 6,000 euro deri në 2,5000 euro"*.

Duke marr parasysh se subjekti politik i lart përmendur, në këto zgjedhje për herë të parë ka kryer veprime të tilla të kundërligjshme në mënyrën e lartpërmendur, PZAP-i, duke vlerësuar edhe rrethanat tjera të lartpërmendura, të njëjtit subjekt i shqipton gjobën e lart cekur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 185/2014 më datën **09.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Ymer Hoxha**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.188/2014, Rishikimi i vendimit të PZAP-it

Parashtruesi i apelit subjekti politik N.N. kundër vendimit të PZAP-it Anr 124/2014.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesi i apelit nuk iu është dhënë mundësia që konform nenit 120 të LZP-së që të ofrojë fakte apo përmirësimin lidhur me shkeljet e pretenduara.

PZAP, pas shqyrtimit të lëndës, vendosi të miratojë si të bazuar apelin, dhe ndryshohet vendimi i PZAP-it, Anr.124/2014, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 dhe 118. paragrafi 4 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Anr.188/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përbërje nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik N.N. dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr 124/2014 të datës 05.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet si i bazuar apeli i subjektit politik N.N. për rishqyrtimin e vendimit Anr 124/2014 të datës 06.06.2014.

II. Ndryshohet vendimi i PZAP-it Anr 124/2014 të datës 06.06.2014, ashtu që subjekti politik N.N. i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 06.06.2014, subjekti politik N.N. dega në Prishtinë, ka parashtruar apel ndaj vendimit të PZAP-it, Anr 124/2014 të datës 05.06.2014 në të cilin kërkon nga PZAP-i që ta rishqyrtoj vendimin në fjalë pasi që për rastin në fjalë lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik X.X. subjektit politik N.N. nuk iu është dhënë mundësia që konform nenit 120 të LZP-së që të ofrojë fakte apo përmirësimin lidhur me shkeljet e pretenduara. Me këtë rast parashtruesi i apelit si dëshmi ka bashkangjitur vendimin Anr 124/2014 dhe fotografat me të cilën dëshmohet veprimi i ndërmarrjes së masave përmirësuese gjegjësisht largimin e posterave nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj apelin gjeti se:

Apeli është i bazuar

Bazuar në Nenin 118.4 të LZP-së i cili parasheh që mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse PZAP-i, mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Me këtë rast subjekti politik N.N. në mbështetje të nenit 118.4 të LZP-së, ka bërë apel ndaj vendimit të PZAP-it duke i ofruar prova të reja të cilat kanë dhe dëshmi konkrete për evitimin e shkeljeve të bëra dhe duke i larguar menjëherë posterat nga vendi i palejuar ku kanë qenë të vendosura ato. Me këtë rast subjekti politik N.N. ka bërë përpjekje dhe ka evituar shkeljen e bërë që PZAP-i, mori si rrethanë lehtësuese dhe e cila ka ndikuar në ndryshimin gjohës së shqiptuar me vendimin Anr 124 /2014 të datës që ka qenë 5100 (pesëmijë e njëqind) euro, dhe për këtë arsye gjoha i zbritet prej 5100 (pesëmijë e njëqind) euro deri në 2000 (dymijë) euro. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 dhe 118. paragrafi 4 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.188 /2014 më datën **06.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Xhevdet Abazi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.190/2014,

Vendosja e njoftimeve në vende të palejuara për mbajtjen e tubimit përmbyllës të fushatës

Parashtuesi i ankesës subjekti politik N.N. ka pretenduar se X.X. ka vendosur njoftime në vende të palejuara, për mbajtjen e tubimit përmbyllës të fushatës zgjedhore.

Më këtë rast pretendohet nga parashtuesi i ankesës se X.X. ka bërë shkelje të legjislacionit, neni 4.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

PZAP-i, lidhur me këtë rast, vendosi të refuzoj si të pabazuara ankesat, në kuptim të neni 118.1 të LZP-së.

Anr. 190/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit X.X. me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së njoftimeve në vende të palejuara, për mbajtjen e tubimit përmbyllës të fushatës, për Zgjedhjet Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.190, Anr.191, Anr.192, Anr.193, Anr.194, Anr.195, Anr.196, Anr.197, Anr.198, Anr.199, Anr.200, Anr.201, Anr.202, Anr.203, Anr.204, Anr.205, Anr.206, Anr.207, Anr.208, Anr.209, Anr.210, Anr.211, Anr.212, Anr.213, Anr.215, Anr.216, Anr.217, Anr.218, Anr.219, Anr.220, Anr.221, Anr.222, Anr.223, Anr.224, Anr.225, Anr.226, Anr.227, Anr.228 dhe Anr. 230, të datës 06.06.2014, të subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.190, Anr.191, Anr.192, Anr.193, Anr.194, Anr.195, Anr.196, Anr.197, Anr.198, Anr.199, Anr.200, Anr.201, Anr.202, Anr.203, Anr.204, Anr.208, Anr.209, Anr.210, Anr.211, Anr.215, Anr.216, Anr.220, Anr.221, Anr.222, Anr.226, Anr.227, Anr.228, Anr.230, të datës 06.06.2014, nga subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, paraqitur kundër X.X. në të cilat ankesa pretendohet se subjekti në fjalë ka bërë shkelje të neni 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013, duke vendosur njoftimin në drunj për tubimin për përmbylljen e fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014.

– Në ankesën Anr.190/2014, pretendohet se në rrugën e “UÇK-së” konkretisht përballë zyrave të “Raiffaisen Bank ” subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.191/2014, pretendohet se në rrugën e “UÇK-së” konkretisht te udhëkryqi tek semaforët, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.192/2014, pretendohet se në rrugën “Fehmi Agani” konkretisht përball objektit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.193/2014, pretendohet se në rrugën e “UÇK-së” konkretisht përballë bankomatit të bankës “TEB”, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.194/2014, pretendohet se në rrugën “Fehmi Agani” konkretisht përballë zyrave të kompanisë “Turkish Airlines”, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.195/2014, pretendohet se në rrugën “Fehmi Agani” konkretisht përballë Kafe bar “91”, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.196/2014, pretendohet se në rrugën “Fehmi Agani” konkretisht në afërsi të udhëkryqit që të dërgon në qendrën tregtare “City Park”, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.197/2014, pretendohet se në rrugën “Luan Haradinaj” konkretisht përballë Qendrës së Regjistrimit Civil (QRC),

subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.198/2014, pretendohet se në rrugën "Luan Haradinaj" konkretisht në mes të Drejtorisë së Policisë së Kosovës dhe Gjykatës Supreme, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.199/2014, pretendohet se në rrugën "Luan Haradinaj" konkretisht përballë Gjykatës Supreme, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.200/2014, pretendohet se në rrugën "Luan Haradinaj" konkretisht përballë Stacionit Qendra Policisë së Kosovës, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një

fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.201/2014, pretendohet se në rrugën “Luan Haradinaj” konkretisht përballë Drejtorisë së Policisë së Kosovës, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.202/2014, pretendohet se në rrugën “Luan Haradinaj” konkretisht përballë Ministrisë së Punëve të Jashtme, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.203/2014, pretendohet se në rrugën “Luan Haradinaj” konkretisht në mes të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.204/2014, pretendohet se në rrugën “Luan Haradinaj” konkretisht përballë monumentit “NEW BORN”, subjekti

X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.205/2014, pretendohet se në sheshin "Zahir Pajaziti" konkretisht përballë më dyqanin "Kolonat", subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.206/2014, pretendohet se në sheshin "Zahir Pajaziti" konkretisht përballë lokalit "Aegun", subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.207/2014, pretendohet se në sheshin "Zahir Pajaziti" konkretisht përballë lokalit "Terranova", subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy

fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.208/2014, pretendohet se në rrugën "Zahir Pajaziti" konkretisht përballë lokalit "CORNER", subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.209/2014, pretendohet se në rrugën "Luan Haradinaj" konkretisht përballë parkingut së Qendrës së Regjistrimit Civil, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.210/2014, pretendohet se në rrugën e "UÇK" konkretisht përballë zyrave të "Pro-Credit Bank", subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

- Në ankesën Anr.211/2014, pretendohet se në rrugën e "UÇK" konkretisht përballë Zyrave të agjencionit "Barileva Travel", subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për

tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.212/2014, pretendohet se në sheshin “Skënderbeu” konkretisht përballë picerisë “Aurora”, subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.213/2014, pretendohet se në rrugën “Agim Ramadani” konkretisht përballë objektit të kuvendit të Kosovës, subjekti X.X. ka vendosur afishe njoftuese në shtylla e ndriçimit, për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.215/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza” konkretisht afër shtatores së Nënës Tereza, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur dy

fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.216/2014, pretendohet se në sheshin “Skënderbeu” konkretisht përballë zyrave të “bankës Ekonomike”, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur tri fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.217/2014, pretendohet se në sheshin “Skënderbeu” konkretisht përballë Hotel “Swiss Diamond”, subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.218/2014, pretendohet se në sheshin “Skënderbeu” konkretisht përballë objektit të Ministrisë së Infrastrukturës, subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.219/2014, pretendohet se në sheshin “Skënderbeu” konkretisht përballë shtatores së “Gjergj Kastriotit Skënderbeut”, subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për

të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.220/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza” konkretisht përballë lokalit “Syri i Kaltër”, subjekti X.X ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.221/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza” konkretisht përballë qendrës informuese të BE-së, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.222/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza” konkretisht përballë objektit të Ministrisë së Bujqësisë, subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresi i ankesës ka bashkangjitur një

fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.223/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza” konkretisht përballë objektit të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, subjekti X.X. ka vendosur në afishe njoftuese në shtyllat e ndriçimit, për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.224/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza” konkretisht përballë dyqanit të syzave dhe orëve “Riza Kompani”, subjekti X.X. ka vendosur afishe njoftuese në shtylla të ndriçimit, për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.225/2014, pretendohet se në sheshin “Zahir Pajaziti” konkretisht përballë shtatores “Zahir Pajaziti”, subjekti X.X. ka vendosur në rrethoja të drunjve afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtresit i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i, të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.226/2014, pretendohet se në sheshin “Nëna Tereza”

konkretisht përballë dyqanit "ON/OFF", subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.227/2014, pretendohet se në rrugën e "UÇK" konkretisht përballë sallorit "Passion", subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.228/2014, pretendohet se përballë objektit të vjetër të komunës së Prishtinës, , subjekti X.X. ka vendosur në drunj afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

– Në ankesën Anr.230/2014, pretendohet se në rrugën e "Nazmi Gafurri" konkretisht përballë Zyrrave të agjencionit "Anti Korrupsion", subjekti X.X. ka vendosur në shtylla elektrike afishe njoftuese për të bërë thirrje për tubime elektorale kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një

fotografi, me propozim që PZAP-i të ndërmerr masat ndëshkimore konform ligjeve në fuqi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, e ka informuar subjektin X.X. lidhur me ankesat më datën 06.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj këtyre ankesave deri më datë 07.06.2014 në ora 19:00.

Brenda afatit të caktuar nga PZAP-i, X.X. ka dhënë përgjigje lidhur me ankesat si në dispozitivë të këtij vendimi, në të cilën përgjigje ka theksuar se provat e bashkangjitura në ankesat e parashtruar në të cilat shihet njoftimi i subjektit X.X. i vendosur nëpër drunjte që janë të mbjell nëpër trotualet e qytetit, në rrethoja të drunjve ndërsa lidhur me ankesat që aludohet nga parashtruesi i ankesave se janë vendosur njoftime në shtylla të ndriçimit publik, sipas përgjigjes në ankesa, nuk është e qartë se për çfarë shtyllash bëhet fjalë. Më tej në përgjigje të ankesave theksohet se sipas ligjit 03/L-073 të LZP-së, dhe Rregullës Zgjedhore nr.11/2013, për "Kodin e Mirësjelljes për Subjekteve Politike" dhe sipas Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për 'Fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për Ngjarjet Publike' në dispozitat e lartpërmendura nuk është fare i specifikuar ndalimi i vendosjes së njoftimeve nëpër vendet ku pretendohet në ankesa. Po ashtu sipas përgjigjes në ankesa potencohet se parashtruesi i ankesave nuk ka specifikuar datën dhe kohën se kur ka ndodhur shkelja e supozuar, që kërkohet sipas dispozitës së nenit 3.4 të Rregullave dhe procedurave të PZAP-it.

Me propozim që PZAP-i, ankesat e parafrazuara ti refuzon si të pabazuara apo si të palejueshme.

Bazuar në nenin 6.3 të "Rregullave dhe Procedurave" të PZAP-it, në të cilin parashihet se: *"Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë"*. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshtënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

PZAP-i, ka konstatuar nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik N.N. paraqitur kundër X.X. në ankesat e lartpërmendura, nuk qëndrojnë ngase veprimet e ndaluar të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore parashihen më nenin 33 të LZP-së dhe më nenin 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2013, në të cilat dispozita nuk specifikohet ndalimi i vendosjes së materialit të shtypur të fushatës së zgjedhjeve në drunj nëpër qytet siç pretendohet në ankesat: Anr.190, Anr.191, Anr.192, Anr.193, Anr.194, Anr.195, Anr.196, Anr.197, Anr.198, Anr.199, Anr.200, Anr.201, Anr.202, Anr.203, Anr.204, Anr.208, Anr.209, Anr.210, Anr.211, Anr.215, Anr.216, Anr.220, Anr.221, Anr.222, Anr.226, Anr.227 dhe Anr.228/2014, po ashtu nuk parashihet ndalimi i vendosjes së këtij materiali sipas dispozitave të lartpërmendura në shtyllën elektrike, shtyllat e ndriçimit dhe në rrethoja të drunjve siç theksohet dhe siç argumentohet më fotografi të bashkangjitura nga parashtruesi i ankesave: Anr.205, Anr.206, Anr.207, Anr.212, Anr.213, Anr.217, Anr.218, Anr.219, Anr.223, Anr.224, Anr.225 dhe Anr.230/2014.

Prandaj duke u bazuar në dispozitat e potencuara më lart dhe shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur shkelja e dispozitave të nenit 33 të LZP-së, nenit 4.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe të Nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore 13/2013, siç pretendohet në ankesat e lartpërmendura dhe po ashtu bazuar në nenin 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet”* dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, mund ti hedh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”,* vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 190/2014 më datën **08.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.236/2014, **thyerja e heshtjes zgjedhore–shpërndarja e SMS**

Parashtguesi i ankesës i subjektit politik N.N. ka pretenduar se kandidati i subjektit politik X.X. ka thyer e heshtjen zgjedhore me përmbajtje të fushatës me shpërndarje të sms.

Më këtë rast pretendohet nga parashtguesi i ankesës se është bërë shkelje e dispozitave ligjore nenit 7 paragrafi 7.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

PZAP, pas shqyrtimit të lëndës, vendosi të miratojë si të bazuar ankesën, në kuptim të nenit 118.1 të LZP–së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

A.nr.236/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik X.X. me seli në Pejë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik, N.N. me seli në Prishtinë, kështu që X.X. i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6500 (gjashtëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 07.06.2014, nga subjekti politik N.N. me të cilën pretendohet se më datë 07.06.2014, edhe pse heshtje zgjedhore, kandidati i X.X. SH.M. ka bërë fushatë duke shpërndarë sms me përmbajtje "Vendos për misionin e ri, voto sot X.X. 58, 1 H.Th. 89 SH.M.". Sms-të janë dërguar tek T.S. në ora 09:15 dhe R.L. në ora 09:13.

Subjekti politik N.N. pretendon se me këtë veprim subjekti politik X.X. ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 7.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Parashtguesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi, në të cilat shihet dërgimi i mesazhit nga subjekti politik X.X. Parashtguesi i ankesës propozon që ndaj subjektit politik të lartë përmendur të ndërmerren masa ligjore në pajtim me LZP.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it informoi subjektin politik X.X. më datë 07.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 08.06.2014, deri në ora 13:00.

PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit – përcaktohen bazuar në Nenin 36.1 të LZP-së dhe Nenin 7.1 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 në të cilat specifikohet se :

Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se padyshim subjekti politik X.X. ka thyer heshtjen zgjedhore, në mënyrën siç pretendohet në ankesë. Një gjë e tillë shihet nga fotografia e telefonit dhe sms nga telefoni i ankuesit, nga i cili rezulton se kandidati i X.X. SH.M. ka dërguar gjatë heshtjes zgjedhore sms me këtë përmbajtje: "Vendos për misionin e ri, voto sot X.X. 58, 1 H.Th. dhe 89 SH.M.". Sms-të janë dërguar tek T.S. në ora 09:15 dhe R.L. në ora 09:13 të datës 07.06.2014.

Bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c), të LZP-së, përcaktohet qartë se në rast se ka ndodhur shkelja e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, PZAP-i mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në lartësi deri në 50000 euro. Sipas Rregullës Nr.01/2012 për "Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave", neni 6 par.2 specifikon se *"në çoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre subjekti politik që është i përfaqësuar në kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjobë nga 6500 euro deri në 25000 euro"*.

Duke marr parasysh se subjekti politik i lart përmendur, në këto zgjedhje për herë të parë ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore në mënyrën e lartpërmendur, PZAP-i, duke vlerësuar edhe rrethanat tjera të lartpërmendura, të njëjti subjekt i shqipton gjobën lart cekur si në diapozitiv të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 236/2014 më datën **08.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.259/2014,

Blerja e votave gjatë ditës së zgjedhjeve

Subjekti politik N.N dega ne Malishevë si parashtruese e ankesës ka pretenduar se aktivisti i subjektit politik X.X, ju kanë ofruar qytetarëve ryshfet për blerjen e votave.

Më këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se aktivisti i subjektit politik X.X ka shkelur legjislacionin zgjedhor. PZAP lidhur me këtë çështje ka vendosur konform dispozitave ligjor te nenit të nenit 120 paragrafi 1 pika c) dhe nenit 120.3 pika d) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) si në dispozitiv të vendimit.

A nr. 259/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik N.N dega ne Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik X.X, dega ne Malishevë, për shkak te blerjes së votave gjatë ditës së zgjedhjeve në qytetin e Malishevës, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014 mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik N.N.

II. Subjektit politik X.X i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

III. A.M nga subjekti politik (X.X), i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik N.N dega në Malishevë në të cilën theksohet se aktivistët e subjektit politik X.X kanë vërejtur se në qytetin e Malishevës konkretisht në vendvotimin në shkollën fillore "Hamdi Berisha" aktivisti i subjektit politik A.M profesor i edukatës fizike, bashkë me një grup të militantëve të subjektit politik X.X, ju kanë ofruar qytetarëve ryshfet për blerjen e votave. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika f) të LZP-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik X.X për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 10.06.2014 deri në ora 09:00

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik (X.X) në të cilën përgjigje theksohet se personi në fjalë A.M nuk është marrë nga policia në vendvotimin ku thuhet, por se ai është marrë jashtë qendrës së këtij vendvotimi diku në një lokal në qytet dhe se nuk është marrë për shkeljen për të cilin pretendon pala ankuese dhe se ankesa në fjalë nuk ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme për tu vërtetuar ato pretendime ankimore.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi të ndërmarr veprimet e nevojshme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës me nr. 2014-GI-71 të datës 08.06.2014 theksohet se me datën 08.06.2014 hetuesit policor mbas marrjes së informacioneve se në furrën e bukës "Bereqeti" në Malishevë përkrahësit e subjektit politik X.X janë duke zhvilluar aktivitete të jashtëligjshme që ndikojnë negativisht në procesin e votimit, rreth orës 14:00 kanë shkuar në vendin e ngjarjes ku me atë rast kanë gjetur brenda hapësirës së furrës së bukës "Bereqeti" ulur në një tavolinë katër persona: (A.M) (H.M) (A.K) dhe (B.M) Sipas raportit të policisë lokali ku ndodheshin personat në fjalë ndodhej përball gjimnazit "Hamdi Berisha" në Malishevë objekti i së cilës ishte duke u shfrytëzuar si qendër e votimit. Gjithnjë sipas raportit të policisë tek personi Y.Y janë gjetur katër kopje të fletëvotimeve të printuara në kolor, ku në këto katër fletëvotimeve në katrorin me nr.59 të X.X ka qenë e shënuar shenja "V" kurse në pjesën e numrave të kandidatëve kanë qenë të rrumbullakuar numrat 1, 17, 44 dhe 65 si dhe janë gjetur edhe dokumente të tjera me emra të lagjeve të ndryshme, lista e anëtareve të KVV-ve, lista e vëzhguesve dhe lista e votuesve. Sipas raportit të policisë Y.Y deklaron se është i caktuar nga subjekti politik Y.Y të kryej detyrën e koordinatorit lokal zgjedhor në Malishevë, ndërsa personi tjetër H.M deklaron se ishte i caktuar nga subjekti politik X.X si vëzhgues rezervë që të kryej detyrën për furnizim me ushqim për vëzhguesit dhe komisionarët e këtij subjekti politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore janë të bazuara pasi që A.M në cilësinë e koordinatorit lokal zgjedhor nga subjekti politik (X.X) ka kryer veprime të kundërligjshme sipas LZP-së ku nga ana e Policisë së Kosovës i janë gjetur katër kopje të fletëvotimeve të printuara në kolor ku të gjitha këto fletëvotime ishin të shënuara me disa numra të rrumbullakuar dhe të shënuara me shenjë për subjektin politik (X.X) e cila mbante numrin 59 . Kjo vërtetohet edhe përmes

raportit policor 2014-GI-71 të datës 08.06.2014 në të cilin përshkruhet në mënyrë të detajuar gjithë ngjarja e ndodhur para kësaj Qendre të Votimit gjatë ditës së zgjedhjeve.

PZAP-i duke vendosur për gjobën ka vendosur në pajtim me nenin 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika c) të LZP, ku është paraparë se PZAP-i ndaj një subjekti politik mund të shqiptoj një gjobë deri në 50.000 €. PZAP-i është i bindur se me gjobën e shqiptuar do të arrihet qëllimi i gjobitjes për subjektin e lartë përmendur në veçanti, dhe për subjektet tjera që bëjnë shkelje të tilla të ligjit në përgjithësi. Ndërsa sa i përket ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi, ka vendosur në pajtim me nenin 120.3 pika d) të LZP, me ç'rast ka marrë në konsiderim se shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e zgjedhore, rrethanë kjo që ka ndikuar në shqiptimin dhe kohëzgjatjen e masës së ndalimit për personin e lartpërmendur në tërësi si në pikën III të dispozitivit.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, dhe në pajtim me dispozitat e lartë përmendura ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 259/2014 më datën **11.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Muharrem Shala**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.266/2014,

Mospërputhja e rezultateve në mes të nënshkrimeve në librin e votuesve

Parashtuesi i ankesës Kandidati për deputet në Kuvendin e Kosovës A.B nga subjekti politik NN dega në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, ne të cilën pretendon se në VV 2130B/02D në kuadër të QV 2130B në Prekaz të Ulët-Skenderaj, ka pasur manipulime të rezultateve nga ana e komisionerëve ku janë bërë shkelje të rregullave zgjedhore.

Më këtë rast pretendohet nga parashtuesi i ankesës se ka mospërputhje të rezultateve në mes të nënshkrimeve në librin e votuesve dhe fletëvotimeve të hedhura në kuti votimi në VV e theksuar me lartë.

PZAP-I konstatoi se ka pasur mospërputhje të rezultateve në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në VV e theksuar me lartë, kështu që miratoi ankesën e subjektit politik NN.

A nr. 266/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), i përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Kandidatit për deputet A.B, nga subjekti politik NN në Prishtinë, për shkak të mungesës së votave, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet A. B. nga subjekti politik NN në Prishtinë,

URDHËROHET KQZ-ja që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrën e Votimit 2130b VV 01R dhe 02D, Prekaz i Ulët, Komuna e Skenderajt, dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të parakohshme Parlamentare të 08 qershorit 2014.

H.V. në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik YY, me nr të letërnjoftimit (.....), i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite si kandidat i subjektit politik YY, ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

S. L në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik NN, me nr të letërnjoftimit (.....) i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i NN-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

N.M në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik **XX**, me nr. të letërnjoftimit (.....) i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i **XX**-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

E.M në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D nga subjekti **OO**, me nr. të letërnjoftimit (.....) i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i **OO**-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

F.V në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik **AA**, me nr. të letërnjoftimit (.....) i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i **AA**-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

M.B në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik **FF**, me nr. të letërnjoftimit (.....) i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i **FF**-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

L.G në cilësi të anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga OJQ N. Tereza me nr. të letërnjoftimit (.....) i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si anëtarë i OJQ-së "Nena Terezë", kandidat i një partie, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Arsyetim

Kandidati për deputet në Kuvendin e Kosovës **A.B** nga subjekti politik **NN**, në Prishtinë, ka parashtruar ankesë më datë 09.06.2014, në të cilën pretendon se në VV 2130B/02D në kuadër të QV 2130B në Prekaz të Ulët-Skenderaj, ka mungesë të votave.

Po ashtu, sipas pretendimeve të parashtruesit të ankesës, si përgjegjës për mungesën e gjithsejtë 65 votave është komisionari i këtij VV.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 10.06.2014 e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën që është paraqitur për mungesën e votave dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, deri më datë 10.06.2014 në ora 13.30, për sigurimin e kopjes së materialit zgjedhor.

Brenda afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ, me nr. 1359/A 2014, të cilës i kanë bashkangjitur materialin zgjedhor për vendvotimin 2130B/01R dhe 2130B/02D si dhe,

- Listën Përfundimtare të Votuesve
- Formularët e Përputhjes së Rezultateve
- Formulave e Rezultateve të Kandidatëve dhe
- Librin e Votimit

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga materiali zgjedhor i QV 2130B/02D, dhe Formulari i Përputhjes së Rezultateve në rubrikën ku shënohet numri i nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve dhe rubrika ku shënohet numri i fletëvotimeve në kuti të votimit për këtë QV ka mospërputhje të rezultatit. Numri i nënshkrimeve në rubrikë është 377 ndërsa numri i fletëvotimeve në kuti është 392.

Nga kjo rezulton, se me këtë rast, konstatohet se ka mospërputhje të rezultateve në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në VV e theksuar me lartë. Për këto arsye, PZAP vlerëson se këto veprime në bazë të nenit 119 paragrafi 5 i LZP-së paraqesin padrejtësi serioze.

Me që PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze, në bazë të nenit 115.1 e lidhur me nenin 119.5 të LZP-së, vendosi ne tersi si ne dispozitiv te këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 266/2014 më datën **12.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

VENDIMI Anr.281/2014,

Manipulim me formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK)

Parashtruesi i ankesës nga subjekti politik **NN**, ka pretenduar se Koalicioni për Kosovën e Re (KRK), ka bërë shkelje të rregullave zgjedhore gjatë procesit të votimit ngase anëtar i Koalicionit **YY** pranë Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Komunën e Malishevës, ka bërë modifikimin e FRK-ve, në kundërshtim me legjislacioni zgjedhor.

Më këtë rast pretendohet nga parashtruesi i ankesës së se Koalicioni KRK respektivisht anëtar i saj, ka rënë në kundërshtim me Neni 45.2 “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë” të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Anr. 281/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik **NN** dega në Malishevë, paraqitur kundër **YY** anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Malishevë, për shkak të manipulimit me formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) në qytetin e Malishevës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014 mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet si e bazuar ankesa e Subjektit Politik **NN**

II. Koalicionit YY i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

III. XX anëtarë pran KKZ-së në Malishevë nga Kosalicioni YY, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë, nga **NN** dega në Malishevë në të cilën theksohet se me datën 09.06.2014 në orën 02:15 të mëngjesit në zyret e KKZ-së në objektin komunal në Malishevë, **XX** anëtar i Koalicionit **YY** pran Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Malishevë është zënë në flagrancë duke manipuluar me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK), ku ai përmes një lapsi me gomë të modifikuar ka bërë ndërhyrje, (fshirje-shënim) në FRK duke ndryshuar rezultatet e votave. Këto shkelje ka arritur që ti zbuloj anëtar i **NN** në KKZ **00** ku përmes vëzhgimit ka arritur që të siguron prova materiale dhe incizime dhe fotografi, si dhe menjëherë në prezencën e të gjithë stafit të KKZ-së, anëtarëve të subjekteve politike në KKZ, trajnerëve dhe kryesuesve të QV në

Drenovc, ka njoftuar policinë e Kosovës e cila e ka arrestuar të dyshuarin dhe gjatë kontrollit të tij ka gjetur mjetin e modifikuar (lapsin grafik me gomë) me të cilin është kryer manipulimi në FRK-të. Parashtruesi i ankesës thekson se veprimi i ndërmarë nga **XX** mund të ketë shkaktuar pasojën në masë shumë më të madhe se sa është evidentuar fillimisht me ndërhyrjen në FRK, pasi që i njëjti më parë ka bërë përpunimin e të dhënave për Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularëve të Përputhjes së Rezultateve. Parashtruesi i ankesës dyshon se këto ndërhyrje në ndryshimin e të dhënave në FRP dhe FRK mund të jenë ndërmarë në dobi të subjektit politik Nisma për Kosovë, dhe si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur deklaratën e **00** dhe fotografit nga vendi i ngjarjes dhe mjetit me të cilin është ndërmarë veprimi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik **YY** lidhur me ankesën në fjalë dhe kërkoi përgjigjen me shkrim për sqarim të mëtutjeshëm.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik **YY**, në të cilën përgjigje theksohet se personi në fjalë **XX** nuk është anëtarë i **YY** pasi që në këto zgjedhje nuk ka ndonjë subjekt politik që ka konkurruar si **YY**, por se i njëjti person është anëtar i KKZ-së në Malishevë i subjektit politik Nisma për Kosovë, dhe se si përfaqësues i **YY** në KKZ-në në Malishevë është.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi të ndërmarr veprimet e nevojshme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se për personin e dyshuar **XX** është hapur rasti me nr. 2014-GE-328 ku me vendim të prokurorit të shtetit është hapur rasti si keqpërdorim i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve dhe se i dyshuari është ndaluar në mbajtje për 48 orë.

PZAP-i për personin në fjalë kërkoi informacione edhe nga KQZ-ja lidhur me verifikimin e anëtarit të KKZ-së për komunën e Malishevës se nga cili subjekt politik është nominuar.

Në përgjigjen e saj KQZ-ja thekson se nga emërimet finale në listën e anëtarëve në KKZ për komunën e Malishevës të emëruar nga KQZ-ja, **XX** figuron në numrin 239 i nominuar nga **YY** dhe se si dëshmi ka bashkangjitur listën me emrat për emërimet e bëra nëpër Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) për Zgjedhjet 2014

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore janë të bazuara pasi që **XX** në anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Malishevë nga Koalicioni **YY** i emëruar nga KQZ-ja si në KKZ Malishevë për zgjedhjet e 2014, ka kryer veprime të kundërligjshme sipas LZP-së ku është zënë duke manipuluar me Formularët e Rezultatete Kandidatëve (FRK) dhe nga Policia e Kosovës ju ka gjetur mjete i modifikuar (lapsi grafik me gomë) me të cilin ka bërë ndërhyrjet (fshirje –shënim) në FRK. Kto veprime të kundërligjshme vërtetohen edhe përmes raportit policor 2014-GE-328 për të cilin i dyshuari është ndalur në mbajtje dhe se ndaj tij është hapur rasti për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve.

PZAP-i duke vendosur për gjobën ka vendosur në pajtim me nenin 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika c) të LZP, ku është paraparë se PZAP-i ndaj një subjekti politik mund të shqiptoj një gjobë deri në 50.000 €. PZAP-i është i bindur se me gjobën e shqiptuar do të arrihet qëllimi i gjobitjes për subjektin e lartë përmendur në veqanti, dhe për subjektet tjera që bëjnë shkelje të tilla të ligjit në përgjithësi. Ndërsa sa i përket ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi, ka vendosur në pajtim me nenin 120.3 pika d) të LZP, me q'rast ka marrë në konsiderim se, shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e zgjedhore, rrethanë kjo që ka ndikuar në shqiptimin dhe kohëzgjatjen e masës së ndalimit për personin e lartpërmendur në tërësi si në pikën III të dispozitivit.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, dhe në pajtim me dispozitat e lartë përmendura ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 281/2014 më datën **12.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*

VENDIMI Anr.392/2014,

Parregullsi në rezultatin përfundimtar të publikuara–bartja e votave të kandidati tjetër

Parashtuesi i ankesës nga subjekti politik NN, YY kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka pretenduar se është dëmtuar nga mos procedimi i 48 votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV me nr. 2501X/08R dhe bartja e votave të tij tek kandidatja tjetër e po të njejtit subjekt politik me numër 75.

Më këtë rast pretendohet se është bërë gabim i paqëllimshëm gjatë plotësimit të FRK-së në QV 2501X/08R në Komunën e Ferizajt, ku del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i votave të kandidatit YY nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së.

Anr. 392/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, YY nga subjekti politik NN, dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

I.Miratohet si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, YY nga radhët subjektit politik NN, dega në Ferizaj.

II.Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik NN në Vendvotimin (VV) 2501X/08R.

III.Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën –II– të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik NN dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit fletëvotimeve është konstatuar se ka 48 vota në VV Nr. 2501X/08R, dhe me rastin e plotësimit të FRK-së numri i këtyre votave është shënuar tek kandidatja tjetër e radhës me numër 75, dhe se ky rezultat figuron ende në rezultatin përfundimtar.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit të QV me nr. 2501X/08R, XX.

Në nenin 117.2 të LZP-së është paraparë: *"Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme", andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:*

Ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati YY nga subjekti politik NN në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 48 votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV 2501X/08R dhe bartja e votave të tij tek kandidatja me numër 75.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2501XD/08R për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 095957, 095958, 095959 dhe 095960 ndërsa shiriti i mesëm nr. 095955 i cili nuk ishte i prekur fare.

Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr. 113470.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr. 76 nga radhët e subjektit politik NN nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 2501X/08R nga hetuesit e PZAP-it del se i njëjti i posedon 47 vota të vlefshme.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklarata e anëtarit të KVV se është bërë gabim i paqëllimshëm gjatë plotësimit të FRK-së në QV 2501X/08R në Komunën e Ferizajt del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i votave të kandidatit YY nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së.

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të*

cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 392/2014 më datën **30.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Ferit Osmani**

Udhëzim Juridik: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.393/2014, Kundër rezultatit preliminar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Parashtuesi i ankesës kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, NN nga radhët subjektiv politik YY, dega në Ferizaj ka pretenduar se gjatë numërimit të fletëvotimeve ka rezultuar se i njeiti ka qenë i votuar nga votuesit në QV 2513D, VV 04D, mirëpo gjatë plotësimit të formularit këto vota nuk janë procesuar në formularin e rezultateve të kandidatëve (FRK) dhe se i njeiti është dorëzuar në QNR i zbrazët.

Me këtë rast pretendohet se është dëmtuar si kandidat dhe se për këtë pretendon se nga ana e komisionarëve të VV 2513D/04D është bërë bartja e votave të tij tek kandidatja tjetër e radhës dhe për kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Anr. 393/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës– NN nga subjektiv politik YY dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014 për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

I.Miratohet si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, NN nga radhët subjektiv politik YY, dega në Ferizaj.

II.Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektiv politik YY në Vendvotimin (VV) 2513D/04D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën –II– të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës–NN të subjektiv politik YY në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit kanë konstatuar se ka fituar vota, por këto vota gjatë plotësimit të formularit nuk ju kanë shënuar fare në numrin 76 dhe ky formular është dorëzuar i zbrazët ku me këtë rast thekson se është dëmtuar si kandidat. Parashtuesi i ankesës ka cekur se ky gabim ka ndodhë në QV.2513D, VV. 04D dhe kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit në VV 2513D/04D- XX dhe kopjen e FRK-së.

Në nenin 117.2 të LZP-së është paraparë: *"Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme", andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:*

Ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati NN nga subjekti politik YY në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 76 votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV 2513D/04D dhe bartja e votave të tij tek kandidatja me numër 75.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2513D/04D për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 141717, 141718, 141715 dhe 141716 ndërsa shiriti i mesëm nr. 000409 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr. 005730.

PZAP-i, ka konstatuar nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 76 nga radhët e subjektit politik YY nuk e posedon asnjë votë, ndërsa pas hapjes së kutisë nga PZAP-i dhe rinumërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin fjalë del se në kutinë e votimit 2513/04D janë 19 fletëvotime të vlefshme të kandidatit të lartpërmendur.

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Andaj një ankesë e tillë vlerësohet si e përgjithshme dhe e pa bazuar në fakte dhe në prova relevante. Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 393/2014 më datën **30.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Ferit Osmani**

Udhëzim Juridik: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

VENDIMI Anr.409/2014, Rezultati përfundimtar i publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Parashtuesi i ankesës subjekti politik NN, pretendon se rezultati i shpallur nga KQZ-ja nuk është në përputhje me vullnetin e shprehur nga ana e votuesve, sepse ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, në mes Formularëve të Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit (FPR), siç rezulton edhe nga provat e ofruara nga vete ankuesi respektivisht subjekti politik NN.

Më këtë rast parashtuesi i ankesës ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në shumë QV dhe VV për shkak të keqpërdorimit të vullnetit të popullit sepse, e tërë kjo është në kundërshtim me Neni 45.2 “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë” të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Anr. 409/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik NN, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

I.MIRATOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e subjektit politik NN përkitazi me kërkesën për rinumërimin e fletëvotimeve në Vendvotimet (VV) në komunën e Klinës 0805C/03R; 0801C/08R; 0817C/01R, Vushtrri 2702X/01R; 2702X/03R; 2713B/03R, Lipjan 1304E/01R; 1325E/01R, Prishtinë 1921E/05R; 1912E/03R; 1907E/02D, Ferizaj 2505D/02R dhe në komunën e Gjilanit 0407D/01R dhe **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për vendvotimet e lartpërmendura dhe po ashtu **ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2014.**

II.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e subjektit politik NN përkitazi me kërkesën që të rinumërohen të gjitha vendvotimet në Kosovë, të anulohen të gjitha votat e ardhura me postë, si dhe që të hetohen votat e shpallura si të pavlefshme vetëm në ato vendvotime ku ka më shumë se 10 fletëvotime të pavlefshme.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.06.2014, nga subjekti politik NN, ku pretendon se rezultati i shpallur nga KQZ-ja nuk është në përputhje me vullnetin e shprehur nga ana e votuesve. Subjekti politik NN ankesën e tyre e ka ndarë në disa pika.

Në pikën 1 te ankesës NN kërkon që të rinumërohen të gjitha vendvotimet pasi që siç thuhet nga rinumërimi i 439 vendvotimeve nga ana e QNR-së në 421 vendvotime është konstatuar keqpërdorimi i vullnetit të votuesve andaj mbi bazën e këtyre informatave NN kërkon rinumërimin e të gjitha vendvotimeve.

Në pikën 2 të ankesës subjekti politik NN kërkon rinumërimin dhe hetimin e këtyre vendvotimeve pasi që dyshohet se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja dhe FPR-ve dhe FRK-ve për këto vendvotime si në vijim; Klinë 0805C/03R; 0801C/08R; 0817C/01R; Vushtrri 2702X/01R; 2702X/03R; 2713B/03R Lipjan 1304E/01R; 1325E/01R Prishtinë 1921E/05R; 1912E/03E; 1907E/02D Ferizaj 2505D/02R; Gjiilan 0407D/01R

Në pikën 3 të ankesës së saj NN kërkon që të anulohen të gjitha votat e ardhura me postë pasi që siç thuhet KQZ nuk ka arritur standarde të votimit me postë dhe se këtë e vërtetojnë edhe votuesit nga Serbia të cilët kanë bërë ankesa në gjykata lidhur me atë se në emër të tyre dikush tjetër ka votuar.

Në pikën 4 subjekti politik NN kërkon nga PZAP që të hetohen votat e shpallura si të pavlefshme vetëm në ato vendvotime ku ka më shumë se 10 fletëvotime të pavlefshme.

Në nenin 117.2 të LZP-së është paraparë *"Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme"*, andaj në bazë të kësaj dispozite juridike, PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës dhe provave të administruara, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Sa i përket pretendimeve ankimore si në pikën dy të ankesës PZAP-i, gjene të njëjtat janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të

Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara nga vete ankuesi, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së PZAP-i urdhëron që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për këto vendvotime si në vijim; Klinë 0805C/03R; 0801C/08R; 0817C/01R; Vushtrri 2702X/01R; 2702X/03R; 2713B/03R Lipjan 1304E/01R; 1325E/01R Prishtinë 1921E/05R; 1912E/03E; 1907E/02D Ferizaj 2505D/02R; Gjilan 0407D/01R, dhe që ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2014.

Ndërsa lidhur me pretendimet tjera ankimore të paraqitura në pikat I, III dhe IV të ankesës në fjalë PZAP-i konsideron se të njëjtat janë të **pabazuara**, pasi që nuk ka prova të besueshme që vejnë në dyshim numërimin e të gjitha fletëvotimeve në vendvotimet në Kosovë. Po ashtu në ankesë nuk janë dhënë prova dhe fakte të pakontestueshme për anulimin e të gjitha votave të ardhura me postë. Aq më tepër rezulton se është i pabazuar pretendimi ankimor që të hetohen votat e shpallura si të pavlefshme vetëm në ato vendvotime ku ka më shumë se 10 fletëvotime të pavlefshme, pasi që në ankesë nuk janë dhënë arsye faktike dhe juridike të pranueshme për hetimin e këtyre votave.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 409/2014 më datën **30.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Ferit Osmani**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

VENDIMI Anr.436/2014,

Kundër rezultatit përfundimtar të publikuar

Parashtuesi i ankesës nga subjekti politik NN dega në Lipjan ka pretenduar se gjatë numërimit të fletëvotimeve në vendvotimin nr.1304 E 02R, është konstatuar se ka pasur modifikim të FRK–ve, si dhe në vendvotimin nr.1324 E 03D rezulton që kandidatin me nr.80 i janë regjistruar 16 vota ndërsa në QNR për këtë kandidat janë konstatuar 56 vota.

Me këtë rast pretendohet se janë bërë veprime të kundërligjshme nga ana e komisionerëve të Qendrave të Votimeve të lartëcekura.

Si rezultat i këtyre manipulimeve me FRK, PZAP–i miratoi ankesën e kandidatin për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga subjekti politik NN.

Anr. 436/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazic dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatin për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, XX nga subjekti politik NN, dega në Lipjan, paraqitur kundër Rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

I.Miratohet si e bazuar ankesa e kandidatin për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, XX nga subjekti politik NN, dega në Lipjan.

II.Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatin e subjektit politik NN në Vendvotimin (VV) 1324E/01R/02R/03D,1304E/02R.

III.Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën –II– të këtij dispozitivi,të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

PZAP–i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati XX për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik NN dega në Lipjan, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit të fletëvotimeve është konstatuar se në vendvotimin nr.1324 E 03D, kandidati XX me nr.80 ka pasur të regjistruara vetëm 16 vota ndërsa gjatë ri-numërimit kanë konstatuar 56 vota. Në vendvotimin nr.1304 E 02R, parashtuesi i ankesës pretendon se ka pasur ndërhyrje (falsifikim) të votave për kandidatin,të ashtu Formulari i Përputhjes së

të dhënave dhe rezultateve nuk është nënshkruar nga të gjithë komisiomerët.

Në vendvotimin nr.1324 E 03D rezulton që kandidatit me nr.80 i janë regjistruar 16 vota ndërsa në QNR për këtë kandidat janë konstatuar 56 vota.

Në vendvotimin nr. 1324 E 03D në Komisionin Komunal Zgjedhor mungon Fleta e tretë e formularit (FPR),sipas parashtruesit të ankesës ky fakt vë në dyshim saktësin e të dhënave,më tutje theksohet se do të duhej të bëhej kontrolli dhe rinumërimi.

Në vendvotimin nr.1324 E 02R,nr faqen 7/7 të gjithë komisionerët ne vendvotimin nuk e kanë nënshkruar formularin.

Parashtruesi i ankesës pretendon se në vendvotimet e lartë shkruara ka pasur shkelje të ligjit dhe rezultatet janë të manipuluar respektivisht janë vjedhur votat e kandidatit me nr 80 XX, sipas kësaj parashtruesi i ankesës ka propozuar për rinumërimin e votave.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar Formularin e Përputhjes se te Dhënave dhe Rezultateve (FPR)

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme ”*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

PZAP- i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati XX nga subjekti politik NN në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i votave në Formularin e Rezultatit të Kandidateve (FRK).

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 1324E/01R për Komunën e Lipjanit ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 110504, 110503, 110502 dhe 110501 ndërsa shiriti i mesëm nr. 110481 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit mbanë numrin 110482.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr 80 posedon 50 votë nga radhët e subjektit politik NN, ndërsa pas hapjes së kutisë së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin në fjalë rezultojnë se i njëjti i posedon 53 vota në kutinë e votimit 1324E/01R siç është pretenduar në ankesën e tij.

-Kutia e votimit me nr. 1324E/02R për Komunën e Lipjanit ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 0035517, 0035516, 0035518 dhe 0035518 ndërsa shiriti i mesëm nr. 122510 i cili nuk ishte i prekur fare.

Shiriti brenda kutisë së votimit nuk ka numër.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr 80 posedon 42 votë nga radhët e subjektit politik NN, po ashtu nga FRK-ja origjinale e rinumëruar kandidati në fjalë i posedon 40 ndërsa pas hapjes së kutisë së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin në fjalë rezultojnë se i njëjti i posedon 45 fletëvotime në të cilat është shënuar numri 80 mirëpo 1 fletëvotim është i pavlefshëm sepse janë të shënuara

mbi 5 kandidatë në kutinë e votimit 1324E/02R, nga kjo del se kandidati në fjalë i posedon 44 vota të vlefshme siç ka pretenduar në ankesë.

-Kutia e votimit me numër 1324E/03D për komunën e Lipjanit është e mbyllur prej 4 shiritave anësor të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë mbajnë numrat 0037073, 0037080, 0035518 dhe 0035519 ndërsa shiriti i mesëm me numër 0034669 nuk është prekur fare.

Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit mban numrin 0037074.

Konstatohet nga FRK-ja origjinale në QNR-në, se kandidati me nr.80 posedon 16 vota nga radhët e subjektit politik NN komuna e Lipjanit, po ashtu nga FRK-ja origjinale e rinumëruar kandidati në fjalë i posedon 56 ndërsa pas hapjes së kutisë së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin në fjalë rezultojnë se i njëjti i posedon 60 fletëvotime ku prej tyre është 1 i pavlefshëm sepse janë shënuar mbi 5 kandidat siç rezulton nga numërimi i 1324E/03D për me tej hetuesit e PZAP-it kanë vërejtur se 14 fletëvotime janë të dyshimta sepse janë mbushur me dy ngjyra të lapsave kimik (me ngjyrë të kaltër dhe të zezë).

Në të gjitha këto raste dyshohet se personi që i ka mbushur fletëvotimet me ngjyrë të zezë është i njëjti sepse të gjitha rastet ku kanë qenë të plotësuar me të kaltër dhe në të gjitha rastet ku kanë qenë më pak se 5 kandidat të shënuar dyshohet se janë plotësuar me laps kimik me ngjyrë të zezë.

PZAP-i i mori 16 fletëvotimet e dyshimta të skanuara për tu prezantuar para panelit.

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1, 117.4 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 436/2014 më datën **30.06.2014**

Kryesuesi i Panelit / **Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

2016

VENDIMI Anr.93/2016, Anulimi i vendimit të KQZ-së

Parashtuesi i apelit, subjekti politik N.N ka paraqitur apel ndaj vendimit të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me numër 1084/2016 të datës 20.11.2016 me të cilën ka kërkuar që të anulohet ky vendim, sepse vendimi i lartpërmendur është në kundërshtim me nenin 20 par. 3 dhe nenin 28 par.1, të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale, dhe me nenin 7 par. 1 të Rregullës Zgjedhore Nr.08/13.

PZAP-i pas shqyrtimit të provave aprovoi apelin e subjektit politik N.N, ashtu që anuloi vendimin e KQZ-së me numër 1084/2016 i datës 20.11.2016, dhe çështja i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe rivendosje dhe hudhi si të palejuar pjesën që i referohet lënies në fuqi të vendimit të KQZ-së, nr. 1024/2016 të datës 12.11.2016.

PZAP-i, konform dispozitave ligjore të nenit 118 par. 1 dhe 5 lidhur me nenin 122 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Anr. 93/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala, Rafet Haxhaj, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik N.N, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, më objekt të kësaj çështje juridike, anulimi i vendimit të KQZ-së, me numër 1084/2016 i datës 20.11.2016, në seancën e mbajtur me datë 22.11.2016, mori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si i bazuar apeli i subjektit politik N.N, me seli në Prishtinë, ashtu që **ANULOHET** vendimi i KQZ-së, me numër 1084/2016 i datës 20.11.2016, dhe çështja i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe rivendosje.

II. Hedhet si e palejuar pjesa e kërkesë së apelit të subjektit politik "N.N" me seli në Prishtinë, në pjesën që i referohet lënies në fuqi të vendimit të KQZ-së, nr. 1024/2016 të datës 12.11.2016, për certifikimin e kandidatit N.B, për Kryetarë të Komunës në Gillogoc, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Lokale.

Arsyetim

PZAP-i, duke vendosur sipas apelit të subjektit politik N.N të datës 18.11.2016, me aktvendimin Anr.91/2016 të datës 19.11.2016, e ka aprovuar si të bazuar apelin e subjektit politik N.N, me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar vendimin i KQZ-së, me numër 1076/2016 i datës 18.11.2016, dhe çështjen ia ka kthyer KQZ-së, në rishqyrtim dhe rivendosje.

KQZ-ja, duke vepruar sipas vendimit të PZAP-it, A.nr.91/2016 të datës 19.11.2016, ka nxjerr vendimin me numër 1084/2016 të datës 20.11.2016, me të cilin vendim në pjesën e parë të dispozitivit ka miratuar rekomandimin Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), lidhur me decertifikimin kandidatit të pavarur N.B. nga gara për Zgjedhjet Lokale të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Glllogoc, që do të mbahen me datën 04.12.2016. Në pjesën e dytë të dispozitivit të të njëjtit vendim KQZ-ja, ka obliguar ZRPPC-në, që ta njoftoi kandidatin e pavarur N.B. për marrjen e këtij vendimi. Dhe në pjesën e tretë të dispozitivit të vendimit të lartpërmendur të KQZ-së, është vendosur që ky vendim të hynë në fuqi me datë 20.11.2016 respektivisht ditën e nënshkrimit të tij.

Parashtruesi i apelit, subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, i pa kënaqur me vendimin e KQZ-së me numër 1084/2016 i datës 20.11.2016, ka parashtruar apel në PZAP ndaj këtij vendimit, më datë 21.11.2016, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i KQZ-së, me numër 1084/2016 i datës 20.11.2016, me arsyetim se vendimi i lartpërmendur sipas parashtruesit të apelit është në kundërshtim me nenin 20 par. 3 dhe nenin 28 par.1, të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale dhe me nenin 7 par. 1 të Rregullës Zgjedhore Nr.08/13. Me propozim për PZAP-in, që të aprovohet apeli si i bazuar dhe të anulohet vendimi i theksuar më lart që ka të bëjë me decertifikimin e N.B. Kandidat për Kryetar të Komunës së Glllogocit, për Zgjedhjet Lokale të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të datës 04.12.2016, ashtu që të mbetet në fuqi vendimi i KQZ-së me numër 1024/2016 i datës 12.11.2016, për certifikimin e kandidatit N.B.

KQZ-ja, në përgjigjen në apel të datës 21.11.2016, ka kundërshtuar apelin e parashtruar, në të cilën ka theksuar se, afatet ligjore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Lokale, siç është në rastin konkret për Kryetar të Komunës në Glllogoc, që do të mbahen me datë 04.12.2016, është konform nenit 1 par. 2, të Rregullës Zgjedhore, Nr.15/2013, në të cilën dispozitë ligjore parashihet së KQZ-ja, mund të ndryshoj afatet kohore, respektivisht të bëhet shkurtimi i afateve zgjedhore, për qeverisjen e zgjedhjeve. KQZ, me datë 04.11.2016, ka miratuar vendimin me nr. 893/16, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore, po ashtu në të njëjtën datë ka miratuar vendimin me nr.898/2016, në të cilin vendim si aktivitet ka paraparë edhe tërheqjen nga procesi zgjedhor i subjekteve politike, një ditë pune para hedhjes së shortit. Prandaj sipas KQZ-së, kërkesa për tërheqje nga gara e kandidatit për Kryetar të Komunës së Glllogocit, për Zgjedhjet Lokale të Jashtëzakonshme, të datës 04.12.2016, ishte brenda afateve, parapara nga KQZ-ja. Më tej në përgjigje në apel KQZ shton se decertifikimi i kandidatit në fjalë nuk e dëmton asnjë aktivitet tjetër zgjedhor, sidomos tani kur është bërë tërheqja e

shortit të subjekteve politike dhe janë në proces të përfundimit disa afate ligjore, siç janë: shtypja e fletëvotimeve (FV), emërimi i Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe aktivitete tjera. Me propozim për PZAP-in, që të refuzohet apeli i parashtruar ndaj vendimit të ankimuar dhe vendimi i KQZ-së, të mbetet në fuqi, ngase në të kundërtën do të shkaktohen çrregullime në masë të madhe të gjitha aktivitetëve zgjedhore për Kryetar Komune në Glllogoc.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë, dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se **apeli është pjesërisht i bazuar**, për këto arsye:

PZAP-i, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, për lejueshmërinë e apelit ndaj vendimit të ankimuar të KQZ-së, të parashtruar nga subjekti politik N.N, si palë e tretë në këtë rast, ka vlerësuar se subjektit politik N.N si person juridik, i janë prekur të drejtat ligjore me vendimin nr.1084/2016 të datës 20.11.2016, të KQZ-së, sipas dispozitës ligjore të nenit 122 par.1, pika c) të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale, sepse parashtruesi i apelit është në garën e njëjtë zgjedhor në Komunën e Glllogocit me Kandidatin e decertifikuar sipas vendimit të lartpërmendur, dhe është pjesë e përbashkët e të gjitha subjekteve politike të certifikuar nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Lokale në Komunën e Glllogocit, që do të mbahen me datë 04.12.2016. Nga kjo rezulton se çdo veprim i ndërmarrë, respektivisht vendime të marra nga KQZ-ja, ndaj njërit prej subjekteve/kandidatëve të pavarur në një proces zgjedhor të njëjtë, i prekin të drejtat ligjore të të gjitha subjekteve/kandidatëve të pavarur, mund të apelohej në PZAP, përfshirë këtu rastin kur kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje, sepse të gjitha subjekte politike me kandidatët e tyre dhe kandidatet e pavarur, janë certifikuar për garën dhe pozitën e njëjtë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit nr.1084/2016 të datës 20.11.2016, të KQZ-së, PZAP-i, ka gjetur se i njëjti nuk është në harmoni me dispozitën ligjore të nenit 28 par.1 të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale, në të cilën parashihet se subjekti/kandidati i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së, njoftimin me shkrim me të cilin shprehet qartazi, qëllimi për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës për hedhjen e shortit për zgjedhje. Në këtë rast KQZ-ja, bazuar në nenin 4.5 të LZP-së dhe nenin 3 të Rregullës Zgjedhore 15/13 ka nxjerr vendimin nr. 893/16 të datës 04.11.2016, për caktimin e afateve të aktivitetëve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Glllogocit, ku në pikën II.d) të vendimit të theksuar më lart,

është paraparë se shorti i fletëvotimit do të mbahet me 18.11.2016, ashtu siç edhe ka ndodhur. Ndërsa KQZ-ja, me vendimin nr. 898/16 të datës 04.11.2016, ka miratuar Planin Operacional për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Glllogocit, ku pjesë e këtij vendimi është Plani Operacional sipas pikës II të dispozitivit të vendimit të lartpërmendur, në të cilin Plan Operacional është specifikuar qartë në pikën 13, se tërheqja nga procesi zgjedhor, pas shkurtimit të afatit zgjedhor nga KQZ-ja, mund të bëhet minimumi një ditë te punës para datës për hedhjen e shortit, në këtë rast hedhja e shortit ishte me datë 18.11.2016, që rezulton sipas vetë vendimit të nxjerr nga KQZ-ja me nr.898/2016 të datës 04.11.2016, së tërheqja nga procesi zgjedhor mund të bëhet me së largu deri me datë 16.11.2016. Më këtë rast PZAP-i, vlerëson se KQZ-ja, ka vendos në kundërshtim me vendimet e veta nr. 893/2016, dhe nr.898/2016 te datës 04.11.2016 dhe ka aprovuar kërkesën për tërheqje, respektivisht e ka decertifikuar nga gara zgjedhore Kandidatin për Kryetar të Komunës së Glllogocit N.B, e cila kërkesë ishte parashtruar pas afatit nga kandidati në fjalë në KQZ me datë 17.11.2016, që del të jetë një ditë pas afatit të paraparë, në vendimin e lart theksuar të KQZ-së, për shkurtimin e afateve zgjedhore, andaj vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Arsyetimi i vendimit të ankimuar se vendimi për decertifikim nr.1076/2016 i datës 18.11.2016, se është marrë edhe në bazë të vullnetit të kandidatit N.B, i cili nuk dëshiron të garoj në zgjedhjet e datës 04.12.2016, PZAP-i, vlerëson se parashtrimet e tilla nuk paraqesin bazë ligjore për marrjen e vendimit të ligjshëm për faktin se në rastin konkret vullneti i kandidatit N.B, duhet të shprehet në pajtim me dispozitat ligjore dhe në afatet e përcaktuara nga KQZ-ja, siç është përcaktuar me vendimin nr. 898 të datës 04.11.2016, ndërsa mbetet në vullnetin dhe mundësin e kandidatit se a do ta praktikon garën e tij në terren apo jo. Ndërkaq sipas afateve kohore të shkurtuara, gjegjësisht të përcaktuara me vendimin e lart cekur të KQZ-së, kërkesa për tërheqje nga gara e datës 17.11.2016, siç u theksua më lart është jashtë afateve të parapara ligjore. Në rastin konkret kandidati në fjalë është dashtë ta parashtron kërkesën e tij, për tërheqje nga gara, për zgjedhjet e datës 04.12.2016, më së largu deri me datë 16.11.2016.

PZAP-i, me rastin e vendosjes, për këtë çështje juridike ka marrë parasysh edhe pretendimet e KQZ-së, të parashtruar në përgjigjen në apel te datës 21.11.2016, se afatet kohore për qeverisjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme mund të ndryshohen nga KQZ-ja, konform nenit 1 par.2 të Rregullës Zgjedhore, Nr.15/2013. Këto afate kohore ne fakt janë ndryshuar nga KQZ-ja, sipas vendimit të KQZ-së me nr.898/2016 të datës 04.11.2016, ku është vendosur që tërheqja nga procesi

zgjedhor mund të bëhet me së largu deri me datë 16.11.2016. Ndërsa me vendimin KQZ-së me nr.1076/16 datë 18.11.2016, është lejuar, decertifikimi i kandidatit N.B, një ditë pas afatit të lartpërmendur, ndërkaq vendimi i ankimuar nuk përmban arsye përkitazi me aprovimin kërkesës të kandidatit N.B, pas afatit të përcaktuar ligjor, mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm pretendimi, se janë respektuar afatet shkurtuara kohore nga KQZ-ja.

Objekt shqyrtimi në PZAP, ishte edhe pretendimet në përgjigje në apel se vendimi për decertifikim të mbetet në fuqi ngase në të kundërtën do të ketë çrregullime në masë madhe të të gjitha aktiviteteve zgjedhore për Kryetar Komune në Gillogoc, sepse ka filluar shtypja e fletëvotimeve, emërimi i KVV-ve dhe aktivitete tjera, paneli i vlerësoi se parashtrimet e tilla nuk paraqesin referenca ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për KQZ-në. Nga fakti se afatet ligjore për ankimim të vendimeve janë prekluzive që duhet të respektohen nga të gjitha palët në procedurë, e që në rastin konkret KQZ-ja, nuk i ka respektuar afatet kohore edhe me rastin e shkurtimit të tyre, siç rezulton nga shkresat e lëndës.

Duke u nisur nga arsyet e theksuar më lart, vendimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja t'i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe riprocedurë, për t'i eliminuar shkeljet esenciale të dispozitave të lartë theksuara ligjore, që janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të ankimuar. KQZ-ja, në ri-procedurë duhet të eliminojë të metat e theksuara në këtë vendim dhe pas vlerësimit të gjitha provave të merr vendim të ligjshëm.

Sipas vlerësimit të panelit, PZAP-i nuk ka juridiksion për të vendosë lidhur me kërkesën në apel përkitazi me mbetjen në fuqi të vendimit të KQZ-së nr.1024/16 datë 12.11.2016, për certifikimin e kandidatit N.B, konform dispozitës së nenit 122 par. 3 të LQP-së, andaj vendosi si në pikën –II– të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga sa u tha me sipër PZAP-i, konform dispozitave ligjore të nenit 118 par. 1 dhe 5 lidhur me nenin 122 të LQP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 93/2016 më datë **22.11.2016**

Kryesuesi i Panelit / **Gyltene Sylejmani**

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme.

VENDIMI Anr.100/2016,

Vendosja e posterit në shtyllë publike

Parashtruesi i ankesës, organizata N.N, ka paraqitur ankesë ndaj subjektit politik X.X, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit për kryetar komune të subjektit të tyre në shtyllë publike, me të cilën pretendon se subjekti politik X.X ka bërë shkeljen e nenit 33 paragrafi 1 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr. 03/L-73.

PZAP-i, pas shqyrtimit të provave aprovoi ankesën e organizatës N.N dhe subjektin politike X.X i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 1.200 euro.

PZAP-i, në kuptim të nenit 118 par. 1 të LZP-së, si dhe nenin 120 par. 1 pika c), LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Anr.100/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr. sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e N.N, Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik X.X, dega në Drenas, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit, në seancën e panelit të mbajtur me 03.12.2016, mori këtë: ulimit me formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) ne qytetin e Malishevës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014 mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e N.N, Prishtinë, Anr.100/2016 të datës 02.12.2016, kështu që subjektit politik X.X, dega në Drenas, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1200 (njëmijë e dy qind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 02.12.2016, ka pranuar një ankesë me numër Anr.100/2016, nga N.N, me të cilën pretendohet se më datë 01.12.2016, rreth orës 14:00 në Sheshin kryesor të qytetit, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Drenasit, kanë vërejtur një parregullësi nga ana e subjekti politik X.X, duke vendosur posterin e kandidatit të tyre për Kryetar Komune të Drenasit, në shtyllë publike.

Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik X.X ka bërë

shkeljen e nenit 33 paragrafi 1 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr. 03/L-73.

Lidhur me këtë rast parashtuesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur një fotografi dhe një CD në të cilën ishte një fotografi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, subjektin politik X.X, e informoi lidhur me ankesën Anr.100/2016 të datës 02.12.2016, të parashtuar nga ana e N.N, dhe kërkoi që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 03.12.2016 në ora 12:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik X.X në të cilën konsiderojnë se janë të pabaza pretendimet e N.N lidhur me shkeljen e nenit 33 paragrafi 1 pika b e LZP-së. Sipas këtij neni të LZP-së thuhet pika b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndertesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndertesave të zëna ose ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, brenda ose në hapsirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Më tej në përgjigjen në ankesë të subjektit politik X.X theksohet se në LZP neni 33 paragrafi 1 pika b nuk ceket se vendosja e posterave në shtyllë publike është shkelje siç pretendon N.N dhe se nga "dëshmitë e ofruara në foto nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një shtyllë publike".

PDK në përgjigje në ankesë shtoi se në ankesën e N.N thuhet se poster i që është vendosur në sheshin kryesor të qytetit, por dëshmitë e ofruara mund të konfirmojnë se fotografia është realizuar në rrugën "Shaban Shala" dhe se në këtë shtyllë sipas tyre nuk shifet asnjë poster. Më tutje subjekti politik X.X thekson se në qoftë se N.N ofron dëshmi shtesë se kemi të bëjmë me shtyllë publike, X.X është e gatshme të largojë posterin nga shtylla në fjalë.

X.X konsideron se nuk kanë prova konkrete nga N.N lidhur me cenimin e nenit 33 paragrafi 1 pika b të LZP-së, dhe kërkon nga PZAP-i që ta hedhë poshtë këtë pretendim të N.N.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për Kryetar të Komunës së Drenasit nga radhët e subjektit politik X.X- R.LI, poster i tij duket i vendosur në hapësirën publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në vende publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik X.X ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se poster i kandidatit për Kryetar Komune të Drenasit ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre.

Prandaj pretendimet e palës përgjegjëse nuk janë bërë të besueshme pasi i njëjti pretendim nuk është argumentuar apo aprovuar me anë të provave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik X.X, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ofruar një fotografi si dëshmi në të cilën duket se ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja dhe se hapësira publike është po e njëjta hapësirë për të cilën kishte bërë ankesë N.N.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik X.X është shkelur neni 33 paragrafi 1 pika (b) të LZP-së, pasi që poster i kandidatit për Kryetar Komune të saj ishte i vendosur në hapësirë publike, si dhe duke pasur parasysh se përgjigjja në ankesë nga ana e X.X kishte të

bashkangjitur një fotografi, ku shifet qartë se janë ndërmarrë veprime për evitimin e shkeljes edhe pse në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK mohohet se ka ndodhur një shkelje e tillë.

PZAP-i në bazë të provës të cilën e ka ofruar të bashkangjitur në përgjigje në ankesë X.X ka caktuar lartësinë e gjobës së shqiptuar, dhe në kuptim të nenit 118.1 dhe 120 paragrafi 1 pika c të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.100 /2016 më datën **03.12.2016**

Kryesuesi i Panelit / **Dr.sc Rafet Haxhaj**

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë konform nenit 118.4 të LZP-së.

VENDIMI Anr.110/2016, Asistim për të votuar

Parashtruesi i ankesës nga NN dhe YY, kanë pretenduar se me datë 05.12.2016 në ditën e votimit një person shihet se si i ndihmon dy persona të ndryshëm për të votuar dhe se personi që ka asistuar në këtë qendër nuk është evidentuar.

Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 89 par 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në Republikën e Kosovës.

PZAP–i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedure dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e bazuar

Anr.110/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Nenad Lazić kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e **NN** dhe **YY**, të dyjat me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 0316e/02d, për shkak të asistimit tek votuesit gjatë ditës së zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit të datës 04.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa Anr.110/2016 datë 05.12.2016 e NN dhe YY, të dyjat me seli në Prishtinë, ashtu që Kryesuesit të Vendvotimit (VV) 0316e/02D BN, me nr. të letërnjoftimit (.....) dhe anëtarëve të të njëjtit Vendvotim, ZZ, me nr. të letërnjoftimit (.....), SS, me nr. të letërnjoftimit (.....) dhe AA, me nr. të letërnjoftimit (.....), ju ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Arsyetim

Me datën 05.12.2016 e NN dhe YY ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se në vendvotimin 0316e/02d në shkollën "Xhevdë Lladrovci" në fshatin Gllanasell të Drenasit një person shihet se si i ndihmon dy persona të ndryshëm për të votuar dhe se personat që kanë asistuar në këtë qendër nuk janë evidentuar askund përkundër asaj se kishte shumë raste të tilla. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 89 par 5 të LZP–së dhe se si dëshmi ka bashkangjitur një CD nga vendi i ngjarjes.

Parashtruesi i ankesës me parashtresën e datës 05.12.2016, ka bërë plotësimin e ankesës duke theksuar se komisionari përgjegjës lidhur me shkeljet e pretenduara si ankesë është **ZZ**, komisioner në vendvotimin 0316e/02D nga subjekti politik **BB**, e i cili kishte për detyrë kontrollimin e letërnjoftimeve dhe evidentimin e votuesve që ndihmonin personat që kishin nevojë për ndihmë.

PZAP-i, po ashtu e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën që është paraqitur dhe duke kërkuar nga KQZ që ta ofroj PZAP-it materialit zgjedhor – librin e votimit për vendvotimin 0316e/02d.

Brenda fatit të përcaktuar PZAP-it pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja me nr 1225A/2016 të cilës përgjigje i ka bashkangjitur materialin zgjedhor – librin e votimit, për vendvotimin 0316e/02d.

PZAP-i me datën 06.12.2016 nëpërmjet telefonit zyrtar mori deklaratën edhe nga **ZZ** komisionar nga subjekti politik PDK i dyshuar lidhur parregullsitë e pretenduara nga pala ankuese, i cili në deklaratën e tij thekson se pretendimet e tilla se një person i gjinisë femërore i ka asistuar për dy persona të njëjtës gjini nuk janë të vërteta pasi që vendvotimin ku ka qene i caktuar për të shërbyer nuk ka vërejtur një rast të tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedure dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e **bazuar** për këto arsye:

Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim.

PZAP-i vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës lidhur me mos evidentimin e personave që i kanë asistuar votuesit për të votuar është i qëndrueshëm sepse nga video incizimi i ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, që gjendet në shkresat e lëndës, shihet qartë se si një person i gjinisë femërore i asiston dy persona respektivisht votuese, për të votuar, ndërsa në librin e votimit për rastin konkret nuk është evidentuar asnjë person se ka votuar gjegjësisht i ka asistuar votuesit për të votuar.

Lidhur pjesën e dispozitivit të këtij vendimi që ju është ndaluar e komisionereve të VV0316e/02D, pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si kandidat

dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), vendimi nga PZAP është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), në të cilin parashihet se "Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet. d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite", pasi që PZAP-i, ka konstatuar se asnjëri nga komisioneret duke e përfshirë edhe kryesin e VV0316e/02D, nuk e kanë ndërmarr asnjë veprim në ditën e votimit të datës 04.12.2016, lidhur me evitimin e shkeljeve, siç është pretenduar në ankesë.

Prandaj PZAP, duke u nisur nga arsyet e theksuar më lart, konform dispozitës ligjore të nenit 89 paragrafi 3 dhe 5 i LZP-së, në të cilën parashihe se një person mund ti asistoj vetëm një votuesi dhe jo disa votuesve, neni 94, 118 par. 1 dhe nenin 120 par.3 pika d) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.110 /2016 më datën 07.12.2016

Kryesuesi i Panelit / **Nenad Lazić**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

VENDIMI Anr.112/2016,

Thyerja e heshtjes zgjedhore–Postimi i një statusi dhe publikimi i një fotografie në rrjetin social FCB

Parashtruesi i ankesës nga N.N organizata, ka pretenduar se kandidati për kryetar komune të Drenasit nga subjekti politik X.X, ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë dhe duke bërë thirrje për votim përmes postimit të një statusi në rrjetin social Facebook. Më këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 36.1 pika b) të LZP-së. PZAP lidhur me këtë ka refuzuar si të pabazuar ankesën konform nenit 5 paragrafi 7 pika b) dhe c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të dispozitave ligjor te nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Anr.112/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazić kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e N.N organizatës me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit X.X nga radhët e subjektit politik Y.Y, dega Drenas, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit të datës 04.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.112/2016 e datës 05.12.2016 me të cilin është pretenduar se kandidati për kryetar të Komunës së Drenasit N.N nga radhët e subjektit politik X.X, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme ka bërë thirrje për votim përmes rrjetit social Facebook.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës organizata N.N me seli në Prishtinë, me datën 05.12.2016 ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se me datë 04.12.2016, gjatë ditës së zgjedhjeve rreth orës 14:00, kandidati X.X, përmes rrjetit social Facebook, ka bërë thirrje për votim, veprime këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, nenin 36 par 1 pika b).

Parashtruesi i ankesës, parregullsisë së evidentuar i ka bashkangjitur si dëshmi një kopje të postimit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Y.Y, lidhur me ankesën e datës 05.12.2016, të

parashtruar në PZAP, nga N.N si dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 07.12.2016 në ora 09:00.

Subjekti politik Y.Y, në përgjigjen në ankesë, thekson se postimi i datës 04.12.2016 në facebook të cilin ankuesi e paraqet si shkelje, nuk është postuar nga kandidati X.X, edhe pse ky postim është bërë nga dikush tjetër, nuk ka thirrje për votim e as për mbështetje të çfarëdo forme tjetër. Me tutje subjekti politik Y.Y në përgjigje thekson se është një foto e një bashkë partiaku të Y.Y, që e ka postuar në facebookun e vet personal dhe i cili sipas Y.Y nuk ka lidhje me pretendimin apo ankesën të cilën e paraqesin ankuesit. Subjekti politik Y.Y konsideron se kjo ankesë është plotësisht e pabazuar, nuk ka prova dhe nuk ka kurrfarë shkelje të nenit 36.1 siç pretendon ankuesi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë, dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se **ankesa është e pabazuar** për këto arsye:

PZAP-i, vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës, se kandidati X.X nga radhët e subjektit politik Y.Y, ka bërë thirrje për votim përmes rrjetit social Facebook gjatë ditës së zgjedhjeve, është i paqëndrueshëm dhe nuk është argumentuar nga parashtruesi i ankesës, pasi që nga fotografia e ofruar, si provë nuk vërehet dhe nuk mund të vërtetohet koha e postimit dhe asnjë detaj tjetër, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 5 par.7 pikat b) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.112 /2016 më datën 07.12.2016

Kryesuesi i Panelit / **Nenad Lazić**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

VENDIMI Anr.124/2016,

Vendosja e posterit në afërsi të Qendrave të Votimit

Parashtruesi i ankesës nga N.N organizata, ka pretenduar se subjekti politik X.X dhe subjekti politik Y.Y gjatë ditës së votimit kanë bërë thyerje të heshtjes zgjedhore ashtu që në fshatin Komoran kanë vendosur posterat e kandidatëve të tyre për kryetar komune të Drenasit, duke i vendosur ato në afërsi prej 100 metrave nga Qendra e Votimit. Më këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se subjektet politike të sipërpërmendura, kanë shkelur legjislacionin zgjedhor konkretisht nenin 36 paragrafi 1 të LZP-së

Lidhur me ankesat në fjalë PZAP-i, i ka miratuar si të bazuara konform dispozitave ligjor të nenit 36 paragrafi 1 pika a) dhe nenit 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

Anr.124/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada Glllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e N.N organizatës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike X.X dhe subjektit politik Y.Y, të dyja me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave të kandidateve të tyre për kryetar, të Komunës së Glllogocit, në Raundin e dytë të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme, në afërsi më të afërt se 100 metra nga Qendra e Votimit (QV), në ditën e votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 21.12.2016, mori këtë:

VENDIM

I. Miratohen si të bazuara ankesat e N.N organizatës Anr.124/2016 të datës 19.12.2016, me seli në Prishtinë, dhe Anr.125/2016 të datës 19.12.2016, ashtu që, Subjekteve Politike **X.X**, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë, në shumë prej 3,000.00 euro (tremijë) dhe subjektit politik **Y.Y**, me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi në shumë prej 3,000.00 euro (tremijë), për shkak të vendosjes së posterave të kandidateve të tyre, për kryetar të Komunës së Glllogocit, në një afërsi më të afërt se 100 metra nga Qendra e Votimit (QV), në ditën e votimit, datë 18.12.2016.

II. Subjektet politike, X.X dhe Y.Y të dyja me seli në Prishtinë, detyrohen ti paguajnë gjokat e shqiptuar si në pikën –I–, të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesave organizata N.N me seli në Prishtinë, me datë 19.12.2016, ka parashtruar dy ankesa Anr.124/2016, dhe Anr.125/2016, në PZAP, kundër subjekteve politike X.X, dhe Y.Y, të dyja me seli në Prishtinë, në të cilat kanë pretenduar se në shkollën fillore "Xheladin Gashi – Plaku", në fshatin Komoran të Komunës së Gllogocit, në ditën e votimit, me datë 18.12.2016, në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, LZP-së, në perimetrin brenda 100 metrave, brenda hapësirës së Qendrës së Votimit 0302e, janë vendosur poster të kandidatëve për kryetar të komunës nga radhët e subjektit politik X.X, dhe kandidatit të subjektit politik **Y.Y**. Më këtë rast parashtruesi i ankesave, për ti argumentuar pretendimet e parashtruara në ankesat e lartpërmendura, i ka bashkangjitur si dëshmi një video – incizim në CD.

PZAP-i, për shkak të ekonomizimit të procedurës në këtë rast, pasi që parashtruesi i ankesës ishte i njëjtë edhe pse ankesat ishin parashtruar ndaj dy subjekteve politike të ndryshme **X.X** dhe **Y.Y** mirëpo shkeljet e pretenduara në ankesat Anr.124/16 dhe Anr.125/16 të datës 19.12.2016, janë të njëjtës natyrë dhe janë në të njëjtin vend, andaj ankesat e theksuar me lart PZAP-i, i ka bashkuar dhe janë vendos me një vendim, duke u bazuar në nenin 8 par. 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka informuar subjektin politik X.X dhe subjektin politik Y.Y lidhur me ankesat e parashtruara nga organizata N.N të datës 19.12.2016, ju ka dhënë mundësinë që të përgjigjen në ankesat e lartpërmendura.

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.12.2016, Subjekti politik X.X, thekson se në videon e shfaqur në CD, duket poster i kandidatit të subjektit politik X.X, por edhe i kandidatit të subjektit politik Y.Y, mirëpo kjo video sipas subjektit politik PDK nuk ka as datë as kohë kur është realizuar kjo video, prandaj subjekti politik X.X, konsideron se pretendimet ankimore të organizatës N.N, janë të pa pabaza në këtë rast.

Subjekti politik Y.Y, në përgjigjen në ankesë të datës 20.12.2016, thekson se subjekti politik Y.Y ka përfill në tërësi heshtjen zgjedhore, nuk ka shpërndarë asnjë material i cili do të ndikonte tek votuesit. Më tutje subjekti politik Y.Y në përgjigje thekson se fotoja qëndron e tillë prej raundit të parë zgjedhor dhe është në distancë me të madhe se 100 metra, dhe se fotoja e vendosur në shtyllë elektrike

është jo vetëm e kandidatit të Subjekti politik Y.Y por edhe e kundër kandidatit të subjektit tjetër.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë, dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

PZAP-i, vlerëson se nga video incizimi i cili gjendet si provë në shkresat e lëndës shihet qartë se distanca në mes të shtyllës dhe objektit të Qendrës së Votimit, ku është objekt i ankimimit është në perimetër më të afërt se 100 metra, në të cilën shtyllë janë vendosur posteret e kandidatëve për kryetar të komunës së Glllogocit, nga radhët e subjekteve politike X.X dhe Y.Y.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në këtë gjendjen faktike të vërtetuar vlerësoj se, subjekti politik X.X dhe subjekti politik Y.Y, kanë bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, gjatë ditës së votimit për Raundin e dytë për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të Komunës në Glllogoc, ku kanë vendosur posterë të kandidatëve të tyre në afërsi me të afërt se 100 metra nga Qendra e Votimit në shkollën fillore "Xheladin Gashi- Plaku" në Komoran të komunës së Glllogoc.

PZAP-i këto veprime të subjektet politike X.X dhe Y.Y, i kualifikoj si shkelje ligjore të dispozitës së nenit 7 par. 1 pika a), Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, lidhur me nenin 36 par.1 pika a) të LZP-së, në të cilat dispozita ligjore parashihet se: *"Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej secili nga veprimet si shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit"*, që në këtë rast sig u theksua me lart posterat e subjekteve politike që janë objekt i ankimimit ishin në një afërsi prej 100 metra brenda hapësirës së QV-së.

Me rastin e përcaktimit të lartësisë së gjobës të vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh këto rrethana:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjektet politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;

- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje si dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, me rastin e vendosjes ka marr parasysh edhe pretendimet nga subjektet politike X.X dhe Y.Y, të parashtruara në përgjigje në ankesa, të cilët kanë theksuar se posterat në fjalë janë të vendosur në vendin e njëjtë që nga rundi i parë i zgjedhjeve të datës 04.12.2016, por të njëjtat i refuzoj si të pabazuara dhe te pa argumentuara me prova, ngase sipas LZP-së, i gjithë materiali propagandistik ku hyn edhe posterat, duhet të largohet nga vendi ku votohet respektivisht nga QV-ja, në një perimetër prej 100 metrave.

Parashtrimet tjera të subjekteve politik u cilësuan si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjekt në fjalë, për faktin se këta pretendimet nuk janë provuar. Palët janë të detyruara që të paraqesin fakte mbi të cilat i mbështesin pretendimet e veta dhe të propozojnë prova me të cilat vërtetohen ato fakte. Rregulla mbi barrën e provave, bije në subjekte politike që t'i provojë faktet mbi të cilat mbështesin parashtrimet e tyre. Për faktin se në rastin subjektet politike këtë nuk e ka bërë, e nga provat e administruara nuk mund të vërtetohet ekzistimit i fakteve mbi të cilat mbështetet këto pretendime PZAP-i, duke aplikuar drejtë rregullën mbi barrën e të provuarit vendosi që parashtrimet në përgjigje në ankesa të subjekteve politik refuzoi si të pabazuara.

Nisur nga të gjitha cekura me lartë, dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 si dhe nenin 120 par. 1 pika c), LZP-së, PZAP-I u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr.124/2016 më datën 21.12.2016

Kryesuesi i Panelit / **Gyltene Sylejmani**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, mund të parashtrohet ankesë e përbashkët nga të dy subjektet politike, në Gjykatën Supreme të Kosovës, pasi që gjopa e përbashkët ndaj dy subjekteve politike është mbi 5,000.00 Euro, në të kundërtën ndaj këtij vendimi nuk mund të parashtrohet ankesa duke u bazuar në nenin 118.4 të LZP-së.



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Rr. "Migjeni"
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 23 505
Email: info@pzap-ks.org



BULETINI

2017





Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



BULETINI 2017